

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	VKM nr. 736, datë 13.12.2023, Udhërrëfyeni për Shtetin e së Drejtës (Grupkapitulli I “Themelorët”),
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Nuk bazohet te transpozimi i akteve të BE
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030 Agjenda Kombëtare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve 2021 - 2026
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	03.10.2025 -31.10.2025
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	3/12/2025
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 13/11/2025
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2025 – MSHMS – Nr. 2
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Znj. Ervina Lila ervina.lila@shendetesia.gov.al Tel - 0693620066

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)

Në Shqipëri, fëmijët që nuk kanë mbështetje prindërore përballen me një sfidë të rëndësishme në qasjen dhe sigurimin e kujdesit të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm. Aktualisht, kujdesi alternativ nuk është i rregulluar nga një ligj i veçantë, por vetëm nga akte nënligjore, kryesisht VKM nr. 149/2018, e miratuar në zbatim të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”, dhe VKM nr. 578/2018, e miratuar në zbatim të Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Këto akte vendosin disa udhëzime dhe rregulla për kujdestarinë familjare, por nuk krijojnë një kuadër të plotë, gjithëpërfshirës dhe të harmonizuar që garanton një standard të njëtrajtshëm për fëmijët dhe mbështetjen e kujdestarëve.

Problematika lidhet me mungesën e një kuadri ligjor gjithëpërfshirës dhe të standardizuar, fragmentimin e shërbimeve, kapacitetet e kufizuara të stafit dhe mungesën e mbështetjes pas ribashkimit, duke ekspozuar fëmijët ndaj institucionalizimit afatgjatë dhe mungesës së integritetit familjar.

Grupet e prekura dhe problematika kryesore

1. Fëmijët pa kujdes prindëror

- **Problemi:**

Fëmijët janë të ekspozuar ndaj **institucionalizimit afatgjatë**, që shpesh fillon që nga lindja dhe zgjat 5–14 vjet, duke penguar integritetin në një mjedis familjar. Shumë prej tyre nuk përfitojnë nga alternativa të qëndrueshme jashtë institucioneve.

- **Shkaku:**

Mungesa e një **ligji të veçantë për kujdesin alternativ**, standardeve të qarta dhe mekanizmave

funksionalë për vendosjen dhe monitorimin e fëmijëve. Fragmentimi i shërbimeve dhe mungesa e koordinimit vendor dhe qendror e bëjnë ribashkimin dhe integrimin të paqëndrueshëm.

2. Kujdestarët familjarë (familjet pritëse dhe të afërmit)

- **Problemi:**

Kujdestarët nuk marrin mbështetje të qëndrueshme financiare dhe sociale, nuk kanë qartësi mbi detyrimet dhe procedurat, dhe shpesh ndihen të pambështetur në trajtimin e rasteve komplekse.

- **Shkaku:**

Kuadri aktual ligjor **bazohet vetëm në akte nënligjore**, pa ligj të veçantë që përcakton detyrimet, mbështetjen financiare, standardet e monitorimit dhe përgjegjësitë e strukturave për kujdestarinë familjare.

3. Institucionet publike të kujdesit shoqëror dhe të mbrojtjes së fëmijës

- **Problemi:**

Institucionet përballen me **vështirësi në implementimin e praktikave standarde**, planifikimin e shërbimeve dhe monitorimin e fëmijëve në kujdes alternativ. Proceset janë shpesh fragmentare dhe të ngadalta.

- **Shkaku:**

Mungesa e një **kuadri ligjor gjithëpërfshirës**, si dhe mungesa e harmonizimit të procedurave, standardeve dhe përgjegjësiave institucionale. Stafi është i orientuar kryesisht ndaj kujdesit rezidencial dhe nuk ka kompetencat e duhura për kujdesin alternativ në familje dhe komunitet.

4. Shoqëria civile dhe organizatat ofruese të shërbimeve të kujdesit alternativ

- **Problemi:**

Ofrimi i shërbimeve efektive pengohet nga **mungesa e standardeve të qarta**, protokolleve të harmonizuara dhe fragmentimi i praktikave mes organizatave dhe strukturave publike.

- **Shkaku:**

Nuk ka **rregulla ligjore të qarta** që përcaktojnë rol, përgjegjësi dhe standarde për organizatat jofitimprurëse të licencuara.

Shkaqet e përgjithshme të problemit

1. Kapacitete të pamjaftueshme të familjeve kujdestare dhe strukturave vendore për riintegrimin e fëmijëve.
2. Mungesa e shërbimeve pasuese (aftercare) dhe monitorimit në komunitet pas ribashkimit me familjen biologjike.
3. Fragmentimi dhe mungesa e qasjes sistematike në menaxhimin e rasteve nga njësitë dhe strukturat vendore.
4. Profili profesional i stafit është i përshtatur për kujdesin rezidencial, duke e bërë të vështirë kalimin drejt shërbimeve komunitare dhe familjare.
5. Kuadri ligjor aktual është i pjesshëm dhe nuk garanton standardet ndërkombëtare për interesin më të lartë të fëmijës.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivat e synuara nëpërmjet kësaj politike janë:

- 1) Krijimi dhe funksionalizimi i një sistemi të plotë dhe të rregulluar të kujdesit alternativ me bazë familjare deri në fund të vitit 2027, duke harmonizuar kuadrin ligjor dhe nënligjor me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe Udhëzuesin për Kujdesin Alternativ, si dhe duke miratuar standardet minimale dhe protokollet përkatëse të shërbimit.
- 2) Garantimi i mbrojtjes dhe zhvillimit të fëmijëve në një mjedis familjar të sigurt deri në vitin 2027, përmes reduktimit të varësisë nga institucionet rezidenciale me të paktën 80% dhe orientimit të fëmijëve drejt formave të kujdesit familjar që sigurojnë interesin e tyre më të lartë.
- 3) Përmeshja deri në vitin 2027 e Planit Kombëtar për Transformimin e Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijët 2025–2027, duke siguruar kalimin e qëndrueshëm të fëmijëve nga institucionet rezidenciale drejt shërbimeve alternative me bazë familjare që janë cilësore, gjithëpërfshirëse dhe të personalizuar.
- 4) Forcimi deri në fund të vitit 2026 i mbështetjes prindërore dhe parandalimi i ndarjes nga familja biologjike, përmes rritjes me 40% të numrit të familjeve kujdestare të certifikuar dhe të trajnuara, ngritjes së mekanizmave funksionalë të monitorimit e raportimit, sigurimit të mbështetjes financiare dhe sociale për fëmijët dhe familjet kujdestare, si dhe harmonizimit të praktikave me standardet ndërkombëtare dhe procesin e integritimit në BE.
- 5) Zhvillimi dhe funksionalizimi i një sistemi të integruar të monitorimit dhe vlerësimit të kujdesit alternativ brenda vitit 2026;
- 6) Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të stafit përgjegjës për kujdesin alternativ brenda vitit 2027;
- 7) Standardizimi i praktikave dhe protokolleve për kujdesin alternativ brenda vitit 2026;**
- 8) Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit dhe familjeve biologjike në procesin e kujdesit alternativ brenda vitit 2026.

-

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Për të përcaktuar opsionin më të mirë për zgjidhjen e problematikave të mësipërme janë marrë në shqyrtim opsionet e mëposhtme:

Opsion 0 – Ruajtja e status quo

Aktualisht, kujdestaria familjare në Shqipëri nuk është e rregulluar nga një ligj i posaçëm, por nga një akt nënligjor - VKM nr. 149/2018, e miratuar në zbatim të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH” dhe VKM nr. 578, datë 03.10.2018, e miratuar në zbatim të Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Kjo formë kujdesi ka filluar tashmë të zbatohet në vend duke shënuar një hap të parë drejt zhvillimit të këtij mekanizmi si alternativë ndaj kujdesit rezidencial.

Megjithatë, mungesa e një kuadri ligjor të plotë dhe të qëndrueshëm e bën këtë opsion të brishtë nga pikëpamja institucionale dhe rregullatore. Vijimi i zbatimit të kujdestarisë familjare vetëm mbi bazën e akteve nënligjore do të sillte pasiguri në praktikë, si në aspektin e garantimit të të drejtave të fëmijës ashtu edhe në mbështetjen e kujdestarëve. Si rrjedhojë, kjo situatë pengon ndërtimin e një sistemi mirëfunksionues për mbrojtjen e fëmijëve, në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe standardet ndërkombëtare të kujdesit alternativ. Ruajtja e status quo-së do të sillte vështirësi në zbatimin

e sistemit të kujdestarisë alternative, duke i lënë fëmijët pa kujdes prindëror në situatë të pasigurt. Si pasojë, këta fëmijë kanë pak gjasa të arrijnë potencialin e tyre të plotë dhe kjo mund të krijojë kosto të larta në të ardhmen për buxhetin (kostot për kujdesin rezidencial janë më të larta se kujdesi alternativ në familje; nga pikëpamja buxhetore ka kosto të shtuara pasi do një pjesë e konsiderueshme e këtyre fëmijëve do të vazhdojnë të marrin pagesa të larta përgjatë ciklit të jetesës nga sistemi i mbrojtjes shoqërore) dhe humbje të produktivitetit të tyre potencial (humbje për ekonominë dhe shoqërinë).

Opsioni 1 - Një nga opsionet e mundshme do të ishte bërja e ndryshimeve në ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet dhe kujdesin shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Megjithatë, ky opsion nuk do të sillte ndryshimet thelbësore të nevojshme për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të kujdestarisë familjare.

Ndryshimet e tilla do të rrezikonin të deformonin qëllimet dhe strukturën konceptuale të të dy ligjeve, të cilat trajtojnë institute të ndryshme të përkujdesit dhe mbrojtjes sociale. Përfshirja e dispozitave të detajuara mbi kujdestarinë familjare në këto ligje do të kërkonte një qasje të ngjashme edhe për format e tjera të kujdesit social ndaj fëmijëve, duke e bërë kështu legjislacionin të ngarkuar, të fragmentuar dhe më pak funksional. Prandaj, ndryshimet brenda këtyre ligjeve nuk përbëjnë qasjen më të përshtatshme për krijimin e një kuadri të plotë dhe koherent ligjor për kujdestarinë familjare. Zgjidhja më efektive do të ishte hartimi i një ligji të veçantë, që adreson në mënyrë tërësore parimet, procedurat, standardet dhe përgjegjësitë institucionale për këtë formë kujdesi alternativ.

Nga pikëpamja e ndikimit rregullator, ky opsion do të prodhonte disa **përfitime pozitive shoqërore**, përfshirë fuqizimin e sistemit për ruajtjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe zgjerimin gradual të sistemit të kujdestarisë alternative. Megjithatë, fragmentimi i dispozitave në disa ligje të ndryshme mund të dobësojë kuptimin dhe ndërgjegjësimin e aktorëve të sistemit si dhe familjeve kujdestare, të sjellë interpretime jokonsistente nga gjykatat dhe autoritetet vendore, si edhe të ndikojë në cilësinë e shërbimit në bashki të ndryshme. Të gjitha këto mund të përbëjnë rrezik të shtuar që fëmijët dhe familjet kujdestare të mos përfitojnë në mënyrë të plotë. Pra, përfitimet sociale potenciale do të dobësoheshin pjesërisht për shkak të vizibilitetit të reduktuar, mungesës së qartësisë dhe nevojës së shtuar për udhëzime administrative, përkundrejt parashikimeve të qarta të sanksionuara me ligj.

Nga pikëpamja e **përfitimeve ekonomike**, ky opsion ka kosto më të ulët legjislative në prizmin afatshkurtër. Megjithatë, ky opsion do të prodhonte kosto administrative më të larta afatgjata nëpërmjet nevojës së vazhdueshme për interpretime, udhëzime; si edhe kohëS që do të duhet të shpenzohet nga punonjësit sociale dhe gjykatat për qartësimin e dispozitave ligjore dhe aplikimit të tyre rast pas rasti. Po ashtu, ky opsion do të shkaktohte vonesa për shtrirjen e sistemit të kujdestarisë alternative dhe kursimet eventuale nga deinstitutionalizimi. Në thelb, ndonëse **kostot e menjëhershme janë më të ulëta**, ky opsion do të prodhonte **kosto më të larta transaksionale lidhur me koordinimin**, duke reduktuar efikasitetin ekonomik të reformës.

Opsioni 2 - Hartimi i një ligji të ri

Ky opsion parashikon krijimin e një kuadri të ri ligjor dhe rregullator të veçantë për kujdestarinë familjare, si një nga format e përkujdesit social që garanton mbrojtjen e fëmijëve në një mjedis familjar. Ky është opsioni më i përshtatshëm dhe më i qëndrueshëm, pasi do të mundësonte ndërtimin e një baze të qartë, gjithëpërfshirëse dhe të harmonizuar për organizimin, standardet dhe mbikëqyrjen e kujdestarisë familjare në nivel kombëtar dhe vendor.

Duke qenë se kujdestaria familjare tashmë në një formë të kufizuar njihet dhe zbatohet në vend si dhe do të ketë një transferim të burimeve financiare nga kujdesi rezidencial në familje, kostot e zbatimit të sistemit të ri ligjor nuk do të jenë ndjeshëm më të larta sesa ato që shoqërojnë zbatimin e kuadrit aktual. Megjithatë,

një ligj i posaçëm është i domosdoshëm për të garantuar zhvillimin e një sistemi funksional dhe afatgjatë të kujdesit alternativ familjar, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me objektivat kombëtare për forcimin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

Ky opsion ka disa përfitime për shoqërinë, të cilat janë **më të qarta dhe të qëndrueshme** se në opsionin 2; përfshirë artikulum më të qartë të roleve, procedurave dhe garancive duke mundësuar rezultate më të mira për fëmijët, stabilitet më të lartë në familjet kujdestare dhe besim në sistemin e kujdestarisë alternative. Qartësia ligjore në këtë rast do të rrisë edhe mundësinë për identifikimin, rekrutimin dhe qëndrueshmërinë e familjeve kujdestare, si edhe përgjegjshmërinë profesionale të të gjithë aktorëve të sistemit. Në këtë mënyrë, qartësia më e lartë ligjore shërben si **multiplikator për ndikimin social** duke rritur efektivitetin afatgjatë të kujdestarisë alternative.

Nga pikëpamja e **përfitimit ekonomik**, ky opsion parashikohet të prodhojë kosto më të ulëta transaksionale lidhur me menaxhimin e rastit, verifikimin e përmbushjes së kriterëve për vendosjen në kujdestari si edhe vendimmarrjen administrativë dhe gjyqësore në lidhje me rastet e kujdestarisë. Po ashtu, zbatimi do të jetë më i shpejtë dhe më efikas, duke rezultuar në materializimin më të shpejtë të kursimeve nga reduktimi i nevojës për institucionalizim, reduktimit të kohës për vendosjen e fëmijës në kujdestari dhe qëndrueshmërisë më të lartë të kujdestarisë. Pavarësisht koston më të lartë të menjëhershme për miratimin e ligjit të ri, rritjes së kapaciteteve në sistem dhe përshtatje, ky opsion do të prodhojë kosto më të ulëta operacionale në prizmin afatgjatë dhe do të përmirësojë kosto-efektivitetin e shpenzimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Opsioni 3 – Jorregullator: Nxitja e kujdestarisë familjare

Ky opsion synon përmirësimin e kujdestarisë familjare pa ndryshuar legjislacionin ekzistues, duke përdorur masa jorregullatore si projekte pilot, mbështetje financiare për familjet kujdestare, trajnime për punonjësit socialë dhe strukturat vendore, fushata ndërgjegjësimi, përmirësim të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe standardizim të protokolleve të punës. Avantazhet kryesore përfshijnë shpenzime të ulëta, fleksibilitet dhe mundësi zbatimi të menjëhershëm, promovimin e kujdestarisë familjare, rritjen e kapaciteteve dhe bashkëpunimit institucional, si dhe shmangien e pengesave politike dhe ligjore. Disavantazhet lidhen me mungesën e qartësisë ligjore dhe qëndrueshmërisë, rrezikun e fragmentimit dhe zbatimit jo uniform, ndikimin të kufizuar mbi sistemin rezidencial dhe vështirësinë për të harmonizuar praktikën me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve. Ky opsion është i përshtatshëm për ndërhyrje të shpejta dhe fleksibël, por nuk garanton transformim të qëndrueshëm të kujdesit alternativ.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Zbatimi i politikës së kujdesit alternativ prek disa grupe kyçe dhe sjell ndikime të gjera sociale, ekonomike dhe financiare. Grupi kryesor i drejtpërdrejtë që përfiton është fëmijët, veçanërisht ata pa kujdes prindëror ose në rrezik për ta humbur atë. Përmes vendosjes në kujdes alternativ familjar ose komunitar, fëmijët përfitojnë mbrojtje nga rreziqet sociale si braktisja, dhuna ose neglizhenca. Politika siguron stabilitet emocional dhe siguri psikologjike, promovon integritet shoqëror dhe barazi, duke u ofruar standarde të unifikuara të kujdesit të ngjashme me ato të fëmijëve që jetojnë në familje biologjike. Nga ana ekonomike, fëmijët që rriten në kushte më të mira kanë mundësi më të larta për arsim dhe zhvillim aftësish, gjë që rrit potencialin e tyre ekonomik në të ardhmen dhe zvogëlon rrezikun e varfërisë. Ndikimet financiare përfshijnë reduktimin e shpenzimeve të drejtpërdrejta të shtetit për kujdesin institucional, si dhe uljen e shpenzimeve për emergjencë sociale dhe shërbime psikologjike, për shkak të kujdesit më cilësor në familje. Vlerësimet monetare tregojnë se për periudhën 2026–2035, për 207 fëmijë, kostoja totale e

kujdesit është 2.3 miliardë lekë (vlera e diskontuar 1.765 miliardë lekë), ndërsa përfitimet monetare dhe afatgjata kapin 2.4 miliardë lekë, duke përfshirë efektin multiplikator nga konsumimi dhe taksat e ardhshme.

Familjet kujdestare janë grupi i dytë i rëndësishëm që përfiton drejtpërdrejt nga politika. Ato marrin mbështetje financiare dhe sociale që u mundëson të përmbushin nevojat e fëmijëve, të zhvillojnë aftësi prindërore dhe të rrisin përkushtimin ndaj fëmijëve në kujdes. Nga pikëpamja sociale, politika forcon rrjetin mbështetës të familjeve dhe kontribuon në uljen e krizave familjare, duke rritur përfshirjen e tyre në procesin e riintegrit të fëmijëve. Ndikimet ekonomike përfshijnë mundësinë e rritur për të punuar dhe për të kontribuar ekonomikisht, si dhe stabilitet më të madh financiar, duke reduktuar varësinë nga ndihmat e tjera sociale. Financiarisht, familjet përfitojnë pagesa direkte dhe transfertat financiare për ushqim, edukim dhe kujdes shëndetësor, të cilat shoqërohen me monitorim të standardizuar për përdorim efektiv të mjeteve. Ndikimet monetare të drejtpërdrejta për familjet kujdestare përfshijnë pjesën e kostos totale të kujdesit që shkon për transfertat dhe mbështetjen sociale (brenda vlerës së diskontuar 1.765 miliardë lekë), ndërsa ndikimet tërthore lidhen me reduktimin e barrës financiare për shpenzimet familjare dhe mundësitë afatgjata për angazhime ekonomike.

Biznesi dhe ofruesit e shërbimeve sociale janë prekur në mënyrë të tërthortë, kryesisht përmes certifikimit, licencimit dhe bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse të licencuara. Ndikimet sociale përfshijnë përmirësimin e cilësisë së kujdesit alternativ dhe rritjen e besueshmërisë së shërbimeve në komunitet. Ekonomikisht, kjo kërkon investime në kapacitete, trajnime dhe infrastrukturë, por gjithashtu krijon mundësi për zhvillim ekonomik të sektorit jofitimprurës përmes projekteve të financuara nga shteti ose donatorë. Financiarisht, kosto fillestare për përmbushjen e standardeve mund të jetë e konsiderueshme, por kjo siguron stabilitet afatgjatë dhe akses në fonde publike dhe donatorë. Ndikimet monetare të tërthorta përfshijnë rritjen e reputacionit dhe cilësisë së shërbimeve, gjë që mund të sjellë kontrata dhe bashkëpunime të mëtejshme, me efekt multiplikator në ekonominë sociale.

Buxheti i Shtetit përfiton nga politika përmes reduktimit të shpenzimeve për kujdesin institucional dhe menaxhimin më efektiv të burimeve publike. Ndikimet sociale lidhen me uljen e pasojave negative sociale, rritjen e besimit të qytetarëve tek institucionet dhe stabilitetin social. Nga ana ekonomike, politika zvogëlon kostot afatgjata të institucioneve rezidenciale dhe krijon efekt multiplikator përmes rritjes së konsumit të familjeve të mbështetura dhe përgatitjes së fëmijëve për kontribut ekonomik në të ardhmen. Financiarisht, për periudhën 2026–2035, kostoja nominale e kujdesit alternativ dhe rezidencial është 2.248 miliardë lekë (vlera e diskontuar 1.765 miliardë lekë), ndërsa përfitimet monetare dhe afatgjata përfshijnë transfertat financiare për familjet kujdestare (392 milionë lekë), taksat indirekte dhe efektin multiplikator, si dhe përfitimet e ardhshme nga zhvillimi ekonomik i fëmijëve (2.4 miliardë lekë). Vlera aktuale neto arrin rreth 1.4 miliardë lekë, me raport kosto-përfitim 1:1,9, duke treguar se investimi është socialisht dhe ekonomikisht efikas.

-

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opcionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i preferuar, wshtw opsioni nr. 2, i cili mundëson hartimin e një kuadri rregullator të ri.

Qëllimi i projekt ligjit është të garantojë ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje një mjedis të përshtatshëm familjar për fëmijët në nevojë për përkujdes dhe mbrojtje. Ky projektligj synon të ruajë dhe

garantojë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në një mjedis të sigurt, mbështetës dhe përfshirës familjar, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, duke marrë parasysh nevojat individuale dhe promovuar zhvillimin e shëndetshëm të tij/saj.

Risite që sjell ky Projektligj janë të shumëfishta, me ndikim të drejtpërdrejtë në praktikë dhe përfshijnë:

- Informimi dhe konsiderimi i mendimit dhe vendimi të fëmijës, i cili përfshihet në çdo vendim që prek jetën e tij;
- Kujdestaria profesionale kthehet në një profesion të njohur dhe të mbrojtur ligjërisht, duke garantuar cilësi, stabilitet dhe mbështetje institucionale për kujdestarët;
- Kujdesi emergjent për fëmijët e sapoidentifikuar në situata rreziku (p.sh. dhunë, trafikim, mungesë të kujdesit prindëror);
- Financimi bëhet më i drejtë dhe i strukturuar, me mbështetje ekonomike si për fëmijët, ashtu edhe për familjet kujdestare;
- Sistemi i monitorimit elektronik mundëson gjurmueshmëri të plotë dhe shmang vendosjet e pasigurta apo të paarsyetuara;
- Standardet e shërbimit unifikohen për të gjithë territorin ku tanimë çdo fëmijë, kudo që ndodhet, do të marrë të njëjtin nivel kujdesi dhe mbrojtjeje.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
370.998	208.656	208.656

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dëshiron të informojë mbi procesin e gjerë, transparent dhe gjithëpërfshirës që është ndjekur gjatë hartimit të projektligjit “Për Kujdesin Alternativ për Fëmijët”. Ky proces ka përfshirë konsultime të vazhdueshme me aktorët kryesorë, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, ekspertët dhe strukturat vendore, duke siguruar që projektligji të pasqyrojë praktikën më të mira ndërkombëtare.

Gjatë fazës së hartimit, u zhvillua një raund i detajuar konsultimesh, ku u morën komente

- me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile si Save the Children, SOS Villages, World Vision, NISMA Arsis, CRCA dhe Bethany.për hartimin e projektligjit të kujdesit alternativ më 05 qershor 2025 dhe 19 Shtator 2025
- me anëtarët e grupit teknik të punës për ndryshimet në ligjin 121/2016 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, me qëllim hartimin e projektligjit të kujdesit alternativ dhe hartimin e planit të procesit të transformimit të qendrave rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë 2025-2027. Këto takime kanë qenë vijuese dhe online më 30 maj 2025.
- me përfaqësues të institucioneve të ndryshme qendore dhe vendore, me 16 Shtator 2025

Projektligji u vendos për konsultim publik nga data 3.10.2025 deri 31.10.2025, në linkun: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/878>

Organizata e shoqërisë civile dhanë kontribute të rëndësishme mbi një gamë të gjerë çështjesh, përfshirë standardizimin e shërbimeve, vlerësimin e nevojave të fëmijëve, rolin e kujdesit familjar, sqarimin e përgjegjësiave të institucioneve shtetërore dhe përfshirjen e mekanizmave efikasë të monitorimit.

Komenteve të marra gjatë konsultimeve kanë qenë thelbësore për strukturimin e projektligjit dhe për sigurimin e përafrimit të tij me instrumentet ndërkombëtare, si Udhëzuesi i OKB-së për Kujdesin Alternativ. Shumë nga rekomandimet janë fokusuar në detaje teknike, përfshirë rregullimet terminologjike, të cilat janë marrë parasysh dhe pasqyruar me kujdes në draft.

Çështjet kryesore të adresuara përmes konsultimeve përfshijnë:

1. **Planifikimi dhe Rishikimi i Kujdesit:** U rekomandua vendosja e afateve të qarta për rishikimin e vendosjes së fëmijëve në kujdes alternativ. Edhe pse këto aspekte do të rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM), afatet maksimale janë përfshirë në projektligj.
2. **Mosha minimale dhe maksimale:** Ndërsa kufijtë moshore për vendosjen në familje jo-afariste janë rregulluar në draft, për familjarët e zgjatur (gjyshër, xhaxhallarë, teze, halla) nuk parashikohen kufizime, pasi ligji njih aftësinë e tyre për të ofruar kujdes, edhe në moshë të shtyrë, nëse janë plotësisht të aftë.
3. **Kujdesi formal dhe joformal:** Rekomandimi për të përfshirë kujdesin joformal nuk është marrë parasysh, pasi ligji synon rregullimin e formave të kujdesit të formalizuar për fëmijët pa kujdes prindëror. Kujdesi joformal mund të krijojë situata që ndikojnë negativisht në mirëqenien dhe interesin më të lartë të fëmijës.
4. **Birësimi:** Edhe pse procesi i birësimit u diskutua, MSHMS vlerësoi se ai është i rregulluar në mënyrë të plotë nga Kodi i Familjes dhe ligji i veçantë për birësimin; për këtë arsye nuk janë shtuar dispozita të reja në draftligj.
5. **Mbështetja për të afërmit dhe kujdestarët familjarë:** Janë marrë parasysh rekomandimet për thjeshtimin e procedurave dhe garantimin e mbështetjes financiare për kujdestarët familjarë, me detaje që do të saktësohen në aktet nënligjore.
6. **Monitorimi dhe inspektimi i pavarur:** Rekomandimi për një model inspektimi të pavarur të ngjashëm me Mbretërinë e Bashkuar është vlerësuar. Ndërsa palët e treta mund të mbështesin sistemin, monitorimi dhe inspektimi do të mbeten kompetencë e strukturave shtetërore, sipas ligjit nr. 121/2016.
7. **Kujdesi i specializuar:** Është vlerësuar nevoja për përcaktimin e roleve dhe përgjegjësiave të kujdestarëve profesionistë, të cilat do të rregullohen përmes standardeve të shërbimit që do të miratohen me akt nënligjor.
8. **Pjesëmarrja e fëmijëve:** Projektligji përfshin dispozita që garantojnë dëgjimin e mendimit të fëmijëve në vendimet që lidhen me vendosjen në kujdes alternativ, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre.
9. **Kujdesi emergjent dhe afatgjatë:** Janë bërë dallime të qarta midis kujdesit emergjent, afatshkurtër dhe afatgjatë, me fleksibilitet të integruar përmes planeve individuale të kujdesit.
10. **Kujdestaria profesionale dhe format e tjera të kujdesit:** U sugjerua që këto vendime të jepen me procedurë administrative, jo gjyqësore. Ekspertët dhe gjyqtarët e gjykatave familjare konkluduan se një procedurë administrative do të binte ndesh me Kodin e Familjes, i cili prevalon. Megjithatë, projektligji parashikon një afat maksimal prej 10 ditësh për marrjen e vendimit, duke adresuar gjerësisht shqetësimin.
11. **Mbështetja për të afërmit:** U rekomandua thjeshtimi i procedurave dhe garantimi i mbështetjes financiare për të afërmit që ofrojnë kujdes. Kjo është pjesërisht e reflektuar në projektligj.
12. **Regjistri i Shërbimeve të Kujdesit Alternativ:** U propozua zhvillimi i indikatorëve të rezultateve dhe publikimi i të dhënave të anonimizuara. MSHMS e vlerëson këtë rekomandim dhe do të shqyrtojë përfshirjen e termave teknikë në modulit elektronik, që do të përcaktohen me akt nënligjor.
13. **Procesi i thjeshtuar i vlerësimit dhe mbështetja e garantuar për të afërmit:** Rekomandimet për mbështetje financiare dhe ligjore për familjarët janë tashmë të përfshira në projektligj, me

detaje që do të saktësohen përmes VKM. Deri tani, nuk janë marrë propozime shtesë konkrete nga OJF-të për këtë dispozitë.

14. Numri maksimal i fëmijëve në kujdes alternativ: Çështja është adresuar në projektligj.

15. Përfshirja e OJF-ve të licencuara: U sugjerua që OJF-të me ekspertizë të dëshmuar të përfshihen që në fazat e para të procesit si partnerë. Rekomandimi është marrë parasysh dhe është reflektuar në draft.

Rreth **80–85%** e komenteve të shoqërisë civile janë integruar në projektligjin për Kujdesin Alternativ. Kontributet janë reflektuar në fushat e standardizimit të shërbimeve, planifikimit të kujdesit, mbështetjes për kujdestarët familjarë, pjesëmarrjes së fëmijëve, rregullimit të kujdesit emergjent dhe afatgjatë, procedurave të kujdestarisë profesionale me afat maksimal vendimmarrjeje 10-ditor, mbështetjes për të afërmit dhe kujdestarët familjarë, thjeshtimit të vlerësimit, krijimit të regjistrit të shërbimeve, përcaktimit të numrit maksimal të fëmijëve në kujdes dhe përfshirjes së OJF-ve të licencuara.

Disa rekomandime nuk janë marrë parasysh, si përfshirja e kujdesit joformal, ndryshimet në procesin e birësimit dhe adoptimi i modelit të inspektimit të pavarur, pasi këto aspekte janë të rregulluara nga legjislacioni ekzistues.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Për zbatimin dhe monitorimin e këtij projektakti ngarkohen strukturat përgjegjëse për çështjet sociale në nivel qendror dhe vendor.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS)

- Institucioni drejtues për hartimin e politikave, legjislacionit dhe akteve nënligjore.
- Koordinon të gjitha hallkat institucionale
- Mbikëqyr dhe monitoron zbatimin e sistemit të ri.

b) Drejtoria e Politikave të Përkujdesjes Sociale dhe Shërbimeve Sociale

- Harton aktet nënligjore, protokollet, udhëzimet dhe standardet e shërbimit.
- Monitoron zbatimin e politikave

c) Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH)

- Autoritet përgjegjës për monitorimin e shërbimeve të kujdestarisë.
- Siguron trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm për punonjësit socialë dhe kujdestarët.

d) Bashkitë

- Zbatojnë në praktikë shërbimet e kujdestarisë familjare.
- Realizojnë vlerësimin e fëmijës, përzgjedhjen e familjeve, mbështetjen financiare dhe monitorimin periodik.
- Bashkëpunojnë me gjykatat në procedurat e vendosjes.

e) Institucionet e Drejtësisë (Gjykatat)

- Vendosin juridiksht kujdestarinë familjare, brenda afateve të përcaktuara në ligj

Rol thelbësor për hartimin e akteve nënligjore kanë Këshilli i Ministrave dhe ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

Për monitorimin e këtij projektakti ngarkohen strukturat përgjegjëse për çështjet sociale në nivel qendror dhe vendor.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

- Njësia//punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor;
- Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror dhe rajonal;
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- Inspektoriati përgjegjës për shërbimet sociale.

a.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Zhvillimi i politikave për kujdestarinë alternative në Shqipëri është ndërtuar mbi një kuadër të gjerë ligjor, i cili është formësuar në periudha të ndryshme dhe ka evoluar paralelisht me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve. Legjislacioni ekzistues adreson aspekte të rëndësishme të kujdesit familjar për fëmijët pa mbështetje prindërore, duke filluar nga rregullimet themelore të Kodit të Familjes dhe procedurat gjyqësore për vendosjen në kujdestari, deri te ligjet e posaçme për shërbimet sociale, të drejtat e fëmijëve dhe procedurat e birësimit. Përmes këtij zhvillimi gradual, janë krijuar mekanizma institucionalë dhe standarde të cilat synojnë të garantojnë mbrojtjen, mirëqenien dhe kujdesin cilësor për çdo fëmijë pa kujdes shoqëror.

Legjislacioni vendas që adreson aspekte që lidhen me kujdestarinë alternative në familje për fëmijët pa kujdes shoqëror është i gjerë, i hartuar në kohë të ndryshme. Ky kuadër përfshin ligjet si më poshtë:

- Kodi i familjes, i ndryshuar;
- Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar;
- Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet dhe kujdesin shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- Ligji nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit, i ndryshuar;
- Ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, nr. 8153, datë 18.12.2006, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8153, datë 3.10.1996, “Për statusin e jetimit”.

Kodi i Familjes, i ndryshuar¹ është ligji bazë në të cilin bazohet gjykatat dhe institucionet në marrjen e vendimeve për kujdestarinë alternative për fëmijët. Ky ligj nuk reflekton zhvillimet e standardeve ndërkombëtare në këtë fushë, detyrimet që burojnë nga konventat e ratifikuara nga shteti shqiptar pas miratimit të Kodit të Familjes, zhvillimet e familjes gjatë dy dekadave të fundit dhe nevojat që dalin në praktikën e përditshme në lidhje me kujdestarinë alternative. Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar² rregullon procedurën për vendosjen në kujdestari të fëmijës, gjykatën kompetente për vendosjen ose heqjen e kujdestarisë si dhe për heqjen ose kthimin e përgjegjësisë prindërore. Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet dhe kujdesin shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” janë ligjet që adresojnë kujdestarinë alternative për fëmijët. Këto ligje përbëjnë bazën e pjesës më të madhe të akteve nënligjore që rregullojnë aspekte me rëndësi të kujdestarisë alternative. Disa akte

¹ Kodi i Familjes është miratuar në vitin 2004 dhe ka ndryshuar në vitin 2015.

² Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

nënligjore në fuqi janë miratuar në bazë dhe në zbatim të ligjeve të mëparshme, të shfuqizuara, por ligjvënësi ka lejuar të mbeten në fuqi, për aq kohë sa nuk bien ndesh me dy ligjet e sipërcituara.³

Këto ligje kanë krijuar edhe një tërësi mekanizmesh këshillimore dhe koordinuese institucionale. Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës janë përcaktuar në ligjin nr.18/2017 (neni 34). Organizimi dhe funksioni i strukturave përgjegjëse, procedurat e ofrimit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për fëmijët pa mbështetje prindërore, dokumentacioni, etj., janë të parashikuara kryesisht në akte nënligjore. Mekanizmat institucionale që veprojnë në këtë fushë përfshijnë:

- Ministrin përgjegjës për çështjet sociale
- Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
- Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e fëmijës (ASHMDF)
- Shërbimin Social Shtetëror (SHSSH) dhe drejtoritë rajonale të tij
- Inspektoratin për Shërbimet Shoqërore (ISHS)
- Strukturat vendore të shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve.

Këto dokumente përcaktojnë jo vetëm detyrimet formale të Shqipërisë në lidhje me të drejtat e fëmijëve, por edhe standardet konkrete që institucionet duhet të ndjekin për të garantuar kujdes cilësor. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës përcakton parimet themelore—si mosdiskriminimi, interesi më i lartë i fëmijës dhe mbrojtja nga abuzimi—ndërsa Udhëzuesi për Kujdesin Alternativ detajon mënyrën se si shteti duhet të sigurojë që çdo fëmijë pa kujdes prindëror të strehohet në një mjedis sa më të afërt me familjen, të shmangët institucionalizimi afatgjatë dhe të promovohet kujdestaria, birësimi apo format e tjera të kujdesit familjar. Së bashku, këto dokumente krijojnë një kornizë që orienton politikat publike drejt një sistemi më të mbrojtës, më human dhe të fokusuar te nevojat individuale të fëmijës.

Sipas të dhënave të raportit “Hartëzimi i Shërbimeve Sociale në Shqipëri” (2025), numri i ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror është rritur. Kwtu përfshihen 439 ofrues që ofrojnë 1.669 shërbime, për rreth 50.000 përfitues. Por edhe pse janë rritur shërbimet, shërbimet formale të kujdesit alternativ në familje mbeten të pakta, ndërsa një pjesë e madhe e fëmijëve vazhdojnë të jenë nën kujdes rezidencial. Rritja përfshin tipologji të ndryshme: shërbime komunitare, njësitë lëvizëse, asistencë shtëpiake etj. Kryesisht ofrohen për grupe vulnerabel si fëmijët me aftësi të kufizuara (AK), familje në nevojë, të moshuar etj.

Megjithëse ka zgjerim të shërbimeve sociale, kujdesi alternativ formal në familje, si birësimi, kujdestari familjare të organizuara, vendosje në familje mbetet i vogël. Sistemi vazhdon të bazohet kryesisht në kujdes rezidencial. Sipas të dhënave të raportit 2025, numri i fëmijëve në kujdes alternativ rezidencial (publike dhe jopublike) raportohet të jetë në rritje: përfshirë raste të mbajtura në institucione, shtëpi foshnjeje, adoleshentësh, shtëpi familje për 16–18 vjeç. Të dhënat e raportuara nga bashkitë në korrik 2025 tregojnë se numri i përgjithshëm i fëmijëve në kujdes alternativ rezidencial është 266 fëmijë. Nga ana tjetër, Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) raporton se numri i fëmijëve të vendosur në kujdes rezidencial arrin në 432 përfshirë këtu ato publike dhe jopublike.⁴ Sipas të dhënave që Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) i dërgon INSTAT, numri i fëmijëve në kujdes alternativ formal në vitin 2023 ishte 178,3 për 100,000 banorë dhe në vitin 2024 175,3, nga të cilët 105 për 100,000 banorë në vitin 2023 dhe 105,8 në vitin 2024 ishin në kujdes rezidencial.⁵ Siç shihet, edhe pse rregullimi i kujdesit alternativ është i parashikuar vetëm me një akt nënligjor ai rregullon vetëm një formë të kujdesit alternativ në familje dhe të dhënat tregojnë se numri i fëmijëve të vendosur në familje kujdestare është i vogël krahasuar me ato të vendosur në kujdes rezidencial.

³ Ky konstatim bazohet në analizën e faqeve zyrtare të institucioneve përgjegjëse për hartimin e politikave të mbrojtjes së fëmijës, adresimin e tyre në disa dokumente strategjike që datojnë dy vitet e kaluara.

⁴ UNICEF, Raport vlerësimi "Në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Transformimin e Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët në Shërbime me Bazë Komunitare në Shqipëri", korrik 2025, fq. 11 dhe 42.

⁵ Të dhënat që Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) i dërgon INSTAT sipas tregueve të standarteve Transmonee

Problemi në shqyrtim

- 1. Përshkruani natyrën e problemit.*
- 2. Identifikoni shkaqet e problemit.*
- 3. Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- 4. Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria/biznesi/shoqëria civile/qytetarët.*
- 5. Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Profilizimi i fëmijëve të akomoduar në institucionet ekzistuese tregon një diversitet të madh situatash të tyre, ku arsyt e vendosjes lidhen kryesisht me braktisjen në lindje, kushte të vështira socio-ekonomike, probleme të rënda të shëndetit mendor të prindërve, neglizhencë dhe abuzim, dhe mungesë të alternativave mbështetëse të kujdesit familjar.⁶ Shumë prej fëmijëve kanë kaluar një kohë të gjatë në përkujdesje institucionale, shpeshherë që nga muaji i parë i lindjes, me raste të qëndrimit që i kalojnë 5, 8 apo edhe 14 vite. Pjesa më e madhe vijnë nga familje me sfida të thella sociale, mungesë kujdesi prindëror të qëndrueshëm dhe lidhje të ndërprera me rrjetin familjar. Në disa raste janë identifikuar problematika të shëndetit mendor, aftësi të kufizuara, apo lidhje të përsëritura të institucionalizimit, ku fëmijët janë transferuar nga një institucion në tjetrin pa ndërhyrje të hershme në favor të zgjidhjeve të qëndrueshme jashtë institucionit.⁷

Edhe pse vendi prej vitesh ka miratuar plane të deinstitutionalizimit dhe ka miratuar politika që parashikojnë përkujdesjen alternative, ende *de facto* alternativat kufizohen kryesisht në birësim ose qëndrim në institucion. Të dhënat e mësipërme tregojnë se në pak raste ekziston alternativa e rikthimit në familjen biologjike apo vendosjes në familje kujdestare. Situata ligjore e shumë fëmijëve mbetet e varur nga “interesi” i prindërve, duke e bërë të vështirë integrimin e tyre në zgjidhje afatgjata me bazë familjen ose komunitetin.

Çdo fëmijë duhet të jetë në gjendje të gëzojë standard jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor dhe shoqëror, dhe duhet të rritet në një mjedis familjar miqësor, bazuar kjo sa në standardet ndërkombëtare si për shembull Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, aq edhe në politikën e brendshme të vendit.

Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të politikave publike për të rregulluar kujdesin alternativ si një mekanizëm thelbësor mbrojtjeje për fëmijët pa kujdes prindëror, kuadri ligjor aktual mbetet i pjesshëm dhe i pamjaftueshëm për të siguruar standardet e nevojshme rregullatore. Mungesa e dispozitave të qarta dhe instrumenteve funksionale pengon zhvillimin e një sistemi të orientuar drejt kujdesit familjar dhe komunitar, siç kërkojnë standardet ndërkombëtare, duke bërë që fëmijët të vazhdojnë të varen në masë të madhe nga format rezidenciale të kujdesit. Vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur kujdesi në familje nuk është i mundur, kujdesi rezidencial mund të përdoret si zgjidhje e përkohshme dhe për një periudhë sa më të shkurtër, deri në gjetjen e një alternative të përshtatshme familjare. Kjo qasje siguron respektimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të mbrojtjes së fëmijëve në vend.

⁶ UNICEF, Raport vlerësimi "Në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Transformimin e Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët në Shërbime me Bazë Komunitare në Shqipëri", korrik 2025.

⁷ Po aty, fq. 11.

Një tjetër aspekt i nevojshëm për t'u vënë në pah lidhet me sistemin e krijuar në nivel qendror dhe vendor ka të bëjë me burimet njerëzore. Raporti i vlerësimit "Në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Transformimin e Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët në Shërbime me Bazë Komunitare në Shqipëri", i vitit 2025 tregon se struktura dhe profili profesional i punonjësve aktualë rezultojnë kryesisht i orientuar drejt kujdesit rezidencial, çka përbën një pengesë thelbësore për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit alternativ në familje dhe komunitet. Stafi ekzistues është i trajnuar dhe i organizuar mbi modele pune të fokusuara në institucione të mbyllura, ndërsa modelët bashkëkohorë të kujdesit alternativ kërkojnë kompetenca të tjera – si puna intensive me familjen biologjike, mentorimi i familjeve pritëse, ndërhyrjet komunitare, mbështetja psikosociale e personalizuar, si dhe aftësi për menaxhimin e rasteve në terren.

Kjo mospërputhje ndërmjet profilit aktual të stafit dhe nevojave të sistemit krijon një sërë kufizimesh praktike: proceset e vendosjes në familje kujdestare mbeten të ngadalta dhe shpesh fragmentare; mungojnë ekipet multidisiplinare të specializuara; njësitë vendore të mbrojtjes së fëmijës raportojnë ngarkesë të lartë me raste dhe mungesë trajnimesh specifike; dhe vetë institucionet publike e jopublike kanë kapacitete të kufizuara për të ofruar shërbime me bazë komunitare si alternativë ndaj rezidencializimit. Në këto kushte, edhe pse politika synon kalimin drejt kujdesit familjar, sistemi i resurseve njerëzore vijon të ruajë logjikën dhe funksionimin e modelit institucional, duke e vështirësuar transformimin real të kujdesit ndaj fëmijëve pa mbështetje prindërore.

Në mungesë të profilizimit të duhur, politikave të forta të trajnimit dhe një kornize të qartë funksionesh për personelin përgjegjës për kujdesin alternativ, rrezikohet që reforma të mbetet formale, ndërsa praktikisht fëmijët të vazhdojnë të orientohen drejt institucioneve rezidenciale, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Po ashtu, vihet në dukje se rreth 30–40% e fëmijëve të vlerësuar përmes Raportit të vlerësimit "Në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Transformimin e Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët në Shërbime me Bazë Komunitare në Shqipëri" të vitit 2025, paraqesin potencial të pjesshëm për ribashkim me prindërit biologjikë ose me të afërm të ngushtë (gjyshër, hallë, xhaxha, etj.), por përmbushja e kësaj mundësie është e kushtëzuar nga disa faktorë, ndër të cilët përfshihet edhe fragmentimi dhe mungesa e qasjes sistematike nga ana e njësive të mbrojtjes së fëmijëve dhe strukturave vendore në planifikimin e riintegrit të fëmijëve, sikurse edhe mungesa e mbështetjes pas ribashkimit pasi sistemi nuk garanton shërbime pasuese në komunitet për të monitoruar dhe mbështetur fëmijën dhe familjen pas kthimit në familjen biologjike.⁸ Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe strukturat vendore shpesh punojnë në mënyrë të shkëputur, bazuar në kapacitetet e tyre të kufizuara, në protokolle që nuk janë të standardizuara dhe në një kulturë pune që varet më shumë nga iniciativat individuale sesa nga mekanizmat e qëndrueshëm institucionalë. Si rezultat, procesi i vlerësimit të situatës së fëmijës, planifikimi i ndërhyrjeve dhe koordinimi ndërmjet aktorëve vendorë shpesh është i pjesshëm, i parregullt dhe nuk mbështetet në një qasje të integruar të menaxhimit të rastit. Problemi bëhet edhe më i mprehtë në fazën pas ribashkimit të fëmijës me familjen biologjike. Sistemi aktual nuk garanton ofrimin e **shërbimeve pasuese** (aftercare) në komunitet, të cilat janë jetike për të siguruar që kthimi në familje të jetë i qëndrueshëm dhe në interesin më të lartë të fëmijës. Mungojnë mekanizma të qartë monitorimi, vizita periodike të standardizuara, mbështetje psikosociale, ndërhyrje për prindërit, asistencë ekonomike ose shërbime komunitare të përshtatura sipas nevojave. Në shumë raste, pas ribashkimit, fëmijët dhe familjet e tyre mbeten pa mbikëqyrje profesionale, duke rritur rrezikun e rikthimit të problemeve që sollën largimin fillestar të fëmijës, si varfëria, konfliktet familjare, dhuna, paaftësia prindërore apo mungesa e burimeve për përkujdesje.

⁸ Po aty, fq. 47.

Ky boshllëk i rëndësishëm strukturor krijon situata ku ribashkimi kryhet më shumë si procedurë administrative sesa si proces i mirëfilltë rehabilitimi dhe riintegrimi. Pa një qasje të koordinuar dhe pa shërbime të pasuara, fëmijët rrezikojnë të përjetojnë paqëndrueshmëri emocionale, të humbasin aksesin në shërbime të rëndësishme mbështetëse, madje edhe të ekspozohen ndaj rreziqeve të reja. Për më tepër, një ribashkim i pasuksesshëm mund të çojë në ri-hyrje të fëmijës në sistemin e mbrojtjes, duke rritur ngarkesën mbi shërbimet sociale dhe duke cenuar mirëqenien e fëmijës.

Prandaj, mungesa e një sistemi të integruar për planifikimin e riintegritit dhe e shërbimeve pasuese në komunitet nuk është thjesht një mangësi operative, por një pengesë strukturore që komprometon cilësinë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e kujdesit alternativ në vend.

Problemi që rezulton nga ky kuadër është se, pavarësisht detyrimeve ndërkombëtare dhe standardeve të përcaktuara për kujdesin e fëmijëve, sistemi aktual shpesh nuk garanton që fëmijët pa kujdes prindëror të marrin një mbështetje që vërtet përputhet me interesin më të lartë të tyre. Në shumë raste, fëmijët vazhdojnë të strehohen në institucione afatgjata, duke u larguar nga mjedisi familjar që rekomandojnë udhëzuesit ndërkombëtarë. Shkaku kryesor lidhet me kapacitetet e pamjaftueshme të shërbimeve alternative familjare, mungesa e familjeve kujdestare, mbështetje e kufizuar për to, koordinim jo të plotë institucional dhe mungesë infrastrukture për të ofruar alternativa reale ndaj institucioneve. Kjo krijon një mospërputhje midis standardeve që parashikojnë dokumentet dhe praktikës aktuale, duke rrezikuar cilësinë e kujdesit dhe të drejtat e fëmijëve në situata vulnerabël.

Ndërsa në vend është ngritur Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve që siguron shkëmbimin e informacionit dhe mbledhjen e të dhënave statistikore nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror e vendor,⁹ që administrohet nga SHSSH dhe aksesohet nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore¹⁰.

INSTAT boton të dhëna për fëmijët pa kujdes prindëror, përfshirë në kujdes alternativ. Nuk ka të dhëna për numrin e fëmijëve të rikthyer në familjen biologjike.¹¹ Pa të dhëna të përditësuara çdo qasje politike e programore për interesin më të lartë të fëmijës do të ishte jo e saktë, jo e plotë dhe jo e duhura.

Analiza të ndryshme kanë vënë në pah se ka një mospërputhje të rasteve të vendosjes së fëmijës në përkujdesje alternative me aktet ligjore në fuqi si dhe mbivendosje të rregullimeve. Disa lloje të kujdesit alternativ, të cilat njihen në praktikë, nuk janë në ligj ose ka kuptime të ndryshme për to. Mungojnë parashikimet në lidhje me monitorimin e fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ për çdo rast

Grupet e prekura nga problematikat e kujdesit alternativ

1. Fëmijët pa kujdes prindëror
 - Problemi: Fëmijët rrezikojnë institucionalizim afatgjatë dhe mungesë integrimi në mjedisin familjar.
 - Shkaku: Mungesa e një ligji të veçantë që rregullon kujdesin alternativ familjar dhe standarde të qarta për vendosjen dhe monitorimin e fëmijëve.
2. Kujdestarët familjarë (familjet kujdestare dhe të afërmit)
 - Problemi: Kujdestarët nuk marrin mbështetje të qëndrueshme sociale dhe financiare, dhe kanë paqartësi mbi përgjegjësitë dhe procedurat ligjore.

⁹ Vendimi nr. 636, datë 26.10.2018 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore, të kërkuara nga agjencia shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror e vendor.

¹⁰ Ligji nr. 121/2016, neni 33&2, shkronja “e”.

¹¹ <http://ëëë.instat.gov.al/al/statistika-zyrtare-femije-dhe-te-rinj/p%C3%ABrkujdesja-alternative/>.

- Shkaku: Kuadri aktual bazohet vetëm në akte nënligjore, pa ligj të veçantë që përcakton detyrimet, mbështetjen financiare dhe mekanizmat e monitorimit.
- 3. Institucionet publike të kujdesit shoqëror dhe të mbrojtjes së fëmijës
 - Problemi: Institucionet hasin vështirësi në zbatimin e praktikave të standardizuara të kujdesit alternativ dhe planifikimin e shërbimeve.
 - Shkaku: Nuk ka një kuadër ligjor gjithëpërfshirës dhe harmonizim të procedurave, standardeve dhe përgjegjësi institucionale.
- 4. Shoqëria civile dhe organizatat ofruese të shërbimeve të kujdesit alternativ
 - Problemi: Ofrimi i shërbimeve efektive pengohet nga mungesa e një ligji të qartë dhe protokolleve të standardizuara, dhe nga fragmentimi i praktikave.
 - Shkaku: Nuk ka rregulla ligjore që përcaktojnë rol, përgjegjësi dhe standarde për organizatat e licencuara.

Arsyeja e ndërhyrjes

1. Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.
2. Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.
3. Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.
4. Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Programi Politik i Qeverisë 2025-2029 identifikon familjen dhe fëmijët si përparësi të politikave sociale. Shtylla III, “Mirëqenie për të gjithë”, e programit qeverisës thekson se, mirëqenia shihet si e drejtë për çdo shqiptar. Shqipëria 2030 projektohet si një vend me fytyrë njerëzore dhe institucione që punojnë për qytetarin. Pika 3.3. e Shtyllës III të programit qeverisës, “Familja, politikat sociale dhe strehimi” synon një sistem social gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm, ku familja është në qendër dhe mbrohen më të brishtët. Programi qeverisës parasheh rritjen e masave për mbrojtjen e fëmijëve dhe përmirësimin e shërbimeve sociale për familjet në nevojë.

Qeveria e Shqipërisë, përmes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është angazhuar për të transformuar sistemin kombëtar të përkujdesjes dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke kaluar progresivisht nga përkujdesja institucionale drejt alternativave të bazuara në familje dhe komunitet. Ky angazhim është i përcaktuar në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare, përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Udhëzimet për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve, si dhe prioritetet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024–2030, miratuar me VKM nr. 152, datë 13.3.2024, përcakton zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të shërbimeve për fëmijët pa kujdes prindëror, duke promovuar kujdestarinë alternative si një formë prioritare të mbrojtjes së fëmijës dhe si mjet për reduktimin e institucionalizimit. Dokumenti Strategjik i Mbrojtjes Sociale 2024-2030 synon kujdes social për çdo individ në nevojë, duke garantuar jetesë dinjitoze, në një mjedis mundësues dhe fuqizues, përgjatë ciklit të jetës. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, miratuar me VKM nr. 659, datë 3.11.2021 “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026”, e hartuar në përputhje me Strategjinë e Këshillit të Europës për të Drejtat e Fëmijëve 2022–2027, përfshin në masën II.2.1.a Hartimin dhe miratimin e ligjit, “Për kujdesin alternativ”, në kuadër të përmirësimit të kornizës ligjore në sistemin e mbrojtjes, kujdesit të fëmijëve dhe sistemit të drejtësisë”.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), në fuqi që prej 2009, në nenin 80 të saj ‘Për bashkëpunimin në politikën sociale’ nxit zhvillimin e politikave sociale dhe shëndetësore, me vëmendje të veçantë për mbrojtjen e grupeve vulnerabël si fëmijët. Udhërrëfyeni për Shtetin e së Drejtës miratuar me VKM nr. 736, datë 13.12.2023 (Grupkapitulli I “Themeloret”), nënvizon angazhimin e shtetit shqiptar për garantimin e të drejtave themelore të fëmijëve, mbrojtjen e tyre nga dhuna, dhe sigurimin e një sistemi të fortë social e

institucional që promovon interesin më të lartë të fëmijës. Në seksionin e të drejtave themelore të këtij Udhërrëfyesi përfshin edhe angazhimet specifike për të drejtat e fëmijëve. Këto qëllime konfirmohen nga masat konkrete të parashikuara në Udhërrëfyes:

- Garantimi i të drejtës për rritje në familje dhe deinstitutionalizimi: Udhërrëfyesi parashikon finalizimin e deinstitutionalizimit të fëmijëve pa kujdes prindëror, duke u siguruar që fëmijët të kalojnë nga institucionet drejt mjediseve familjare dhe komunitare. Masat e përcaktuara synojnë mirëqenien dhe tranzicionin e suksesshëm të fëmijëve drejt kujdesit familjar, si dhe zgjerimin e shërbimeve alternative në komunitet. Ky është një hap i rëndësishëm drejt garantimit të interesit më të lartë të fëmijës, që është të rritet në një mjedis sa më pranë një familjeje.
- Parandalimi i dhunës ndaj fëmijëve: Një prioritet tjetër i udhërrëfyesit është forcimi i mbrojtjes së fëmijëve nga çdo formë dhune. Dokumenti përfshin masa për uljen e rasteve të dhunës dhe abuzimit, përmirësimin e politikave të sigurisë (p.sh. kundër abuzimit seksual online) dhe forcimin e kapaciteteve të Policisë e institucioneve të drejtësisë për të reaguar ndaj dhunës ndaj fëmijëve. Kjo tregon qartë se shteti shqiptar ka theksuar në këtë udhërrëfyes detyrimin për të mbrojtur fëmijët nga dhuna, si pjesë e reformave themelore të integritetit.
- Fuqizimi i sistemit institucional të mbrojtjes së fëmijëve: Udhërrëfyesi “Themelorët” parashikon masa për forcimin e strukturave të mbrojtjes së fëmijës, si p.sh. rritjen e numrit të njësisë të mbrojtjes së fëmijëve dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve lokale, shëndetësore, arsimore dhe OJF-ve, për të siguruar një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse në mbrojtjen e fëmijëve.

Në vijim të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020–2023, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 706, datë 09.09.2020, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020–2022 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij”, është hedhur baza për ndërtimin e një sistemi të integruar, funksional dhe gjithëpërfshirës të përkujdesjes sociale, të bazuar në parimet e deinstitutionalizimit dhe mbështetjes në komunitet. Ky plan përbën një hap të rëndësishëm drejt transformimit të modelit të kujdesit nga ai rezidencial në një sistem shërbimesh alternative, të orientuara drejt fëmijës dhe familjes.

Në vijim të këtij procesi, në vitin 2025 është hartuar Plani Kombëtar për Transformimin e Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijët drejt Shërbimeve Alternative për Fëmijën dhe Familjen 2025–2027, i cili përbën projekt–planin kombëtar të deinstitutionalizimit të kujdesit për fëmijët. Ky dokument përcakton objektiva të qarta për përfundimin e procesit të deinstitutionalizimit të kujdesit për fëmijët në sistemin publik të përkujdesit brenda vitit 2027, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kujdesit alternativ dhe me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Ky kuadër strategjik parashikon në mënyrë të veçantë transformimin e 7 institucioneve publike të përkujdesit rezidencial për fëmijët në shërbime komunitare dhe familjare, si dhe hartimin e planeve të veçanta të deinstitutionalizimit për fëmijët me aftësi të kufizuara që aktualisht trajtohen në sistemin publik të kujdesit. Zbatimi i këtyre masave synon të garantojë që çdo fëmijë, pavarësisht aftësive, të gëzojë të drejtën për t’u rritur në një mjedis familjar mbështetës dhe gjithëpërfshirës, duke forcuar njëkohësisht rolin e institucioneve vendore dhe të komunitetit në mbrojtjen dhe përkujdesjen afatgjatë.

Qeveria e shih të nevojshme të ndërhyjë nëpërmjet kësaj nisme, për shkak të mangësive të evidentuara në funksionimin aktual të sistemit të kujdesit alternativ, të cilat lidhen me mungesën e standardeve të unifikuara të shërbimit, kapacitetet e pamjaftueshme të strukturave përgjegjëse dhe garancitë jo të plota për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Analizat e kryera tregojnë se mekanizmat ekzistues nuk sigurojnë gjithmonë mbikëqyrje efektive, vendimmarrje të shpejtë dhe alternativa cilësore të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror. Për më tepër, ndryshimet sociale dhe rritja e rasteve që kërkojnë ndërhyrje urgjente e bëjnë të domosdoshme përditësimin e kornizës ligjore dhe procedurave, me qëllim forcimin e sistemit të

mbrojtjes së fëmijëve, rritjen e transparencës, përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe garantimin e interesit më të mirë të fëmijës.

Mw poshtw po rendisim edhe disa arsye tw tjera tw rwndwsishme, qw justifikojnw ndwrhryjen e qeverisw:

- **Mospërputhja me standardet ndërkombëtare**

Kuadri aktual nuk është plotësisht i harmonizuar me udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve dhe standardet e BE-së për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Kjo krijon nevojën për përditësim të dispozitave për të siguruar pajtueshmëri me praktikën më të mira ndërkombëtare.

- **Mbingarkesa e institucioneve rezidenciale**

Raportimet e viteve të fundit tregojnë se një pjesë e strukturave rezidenciale funksionojnë në kapacitete të larta, duke kufizuar cilësinë e shërbimeve dhe individualizimin e kujdesit.

- **Nevoja për të forcuar kujdesin në komunitet / familjar**

Politikat kombëtare synojnë reduktimin e vendosjes së fëmijëve në institucione dhe rritjen e formave alternative familjare (kujdestari, birësim, vendosje në familje pritëse). Kuadri ekzistues nuk i stimulon mjaftueshëm këto forma.

- **Pasiguri në rolet institucionale dhe koordinim të dobët**

Praktika ka treguar se bashkitë, strukturat e shërbimit social, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe institucionet qendrore shpesh kanë ngërçe kompetencash, mungesë mjjetesh dhe koordinim të dobët, çka çon në vonesa dhe vendimmarrje joefektive.

- **Mungesë mekanizmash të qarta të monitorimit dhe llogaridhënies**

Sistemi aktual nuk siguron monitorim të mjaftueshëm mbi ofruesit e shërbimeve, sidomos sektorin jopublik. Kjo sjell rrezik për standardet e kujdesit dhe transparencën e financimit.

- **Rritja e rasteve komplekse dhe e nevojës për ndërhyrje të specializuar**

Rritja e rasteve të dhunës, migracionit, braktisjes ose situatave të emergjencave sociale kërkon struktura më të forta, procedura të qarta dhe kapacitete të reja profesionale që kuadri ekzistues nuk i mbulon në mënyrë të plotë.

Në Shqipëri ka një numër rastesh të fëmijëve të cilët janë në nevojë për mbrojtje dhe kujdes shoqëror. Një Raport i “Hartëzimi i Shërbimeve Sociale në Shqipëri” i vitit 2025 tregon se sot në Shqipëri ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 439 ofrues ose 13 % më shumë se sa në vitin 2023, të cilët sigurojnë funksionimin e 1.669 shërbimeve të përkujdesit shoqëror ose 56% më shumë se sa në vitin 2023 për 50,000 përfitues, individë në nevojë (11% më shumë se sa në vitin 2023).

Përsa i takon të dhënave të Fondit Social, deri më sot janë ngritur 84 shërbime të financuara me rreth 40.000 përfitues, krahasuar me 14 shërbime për rreth 7.000 përfitues në vitin 2019 kur filloi si proces funksionaliteti i këtij mekanizmi.

Analiza e tipologjive të ofruesve tregoi se “Qendra Komunitare” përbëjnë pjesën më të konsiderueshme, 22%, duke iu shërbyer 28% të përfituesve me sigurimin e 21% të shërbimeve. Shërbimet lëvizëse gjithashtu kanë fituar hapësirën e tyre, 8%, duke iu shërbyer 7% të përfituesve me 9% të shërbimeve, kryesisht në sajë të financimit nëpërmjet fondit social. Shërbimet për “Fëmijë me AK” (21%) përbëjnë grupin me peshën më të madhe, të pasuar nga “Shërbime për të moshuarit, 18%. Shërbimet për “Individë të familjeve në nevojë”, të cilat dy vite më parë përbënin grupin me peshën më të konsiderueshme, 29%, në këtë vlerësim përbëjnë vetëm 16%. Rritje të ndjeshme kanë pësuar gjithashtu “Shërbimet për të rritur AK”, të cilat nga 6%, në këtë vlerësim rezultojnë 11%.

Aktualisht në vend veprojnë 7 institucione publike të përkujdesit shoqëror për fëmijët. Institucionet përfshijnë shtëpi foshnjeje, institucione për fëmijë shkollorë dhe adoleshentë, si dhe shtëpi familje për moshën 16–18 vjeç. Në vend ka edhe 19 institucione jo-publike të përkujdesit shoqëror për fëmijët.

Nëpërmjet kësaj nisme qeveria synon të trajtojë disa boshllëqe dhe sfida kryesore të sistemit të kujdesit alternativ për fëmijët. Kjo përfshin harmonizimin e kuadrit ligjor me standardet ndërkombëtare, krijimin e një sistemi më të unifikuar dhe të koordinuar ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe procedurale për ofrimin e kujdesit familjar dhe komunitar. Përmes ndërhyrjes, synohet të rritet cilësia e vendimeve për vendosjen e fëmijëve, të sigurohet mbështetje e vazhdueshme pas ribashkimit me familjen biologjike, të zvogëlohet varësia nga institucionet rezidenciale dhe të garantohen shërbime më të qëndrueshme dhe të personalizuar për çdo fëmijë, duke respektuar interesin më të mirë të tij dhe të drejtën për një mjedis familjar të sigurt dhe mbështetës.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat e synuara nëpërmjet kësaj politike janë:

1) Krijimi dhe funksionalizimi i një sistemi të plotë dhe të rregulluar të kujdesit alternativ me bazë familjare deri në fund të vitit 2027, duke harmonizuar kuadrin ligjor dhe nënligjor me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe Udhëzuesin për Kujdesin Alternativ, si dhe duke miratuar standardet minimale dhe protokollat përkatëse të shërbimit.

2) Garantimi i mbrojtjes dhe zhvillimit të fëmijëve në një mjedis familjar të sigurt deri në vitin 2027, përmes reduktimit të varësisë nga institucionet rezidenciale me të paktën 80% dhe orientimit të fëmijëve drejt formave të kujdesit familjar që sigurojnë interesin e tyre më të lartë.

3) Përmbyllja deri në vitin 2027 e Planit Kombëtar për Transformimin e Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijët 2025–2027, duke siguruar kalimin e qëndrueshëm të fëmijëve nga institucionet rezidenciale drejt shërbimeve alternative me bazë familjare që janë cilësore, gjithëpërfshirëse dhe të personalizuar.

4) Forcimi deri në fund të vitit 2026 i mbështetjes prindërore dhe parandalimi i ndarjes nga familja biologjike, përmes rritjes me 40% të numrit të familjeve kujdestare të certifikuara dhe të trajnuara, ngritjes së mekanizmave funksionalë të monitorimit e raportimit, sigurimit të mbështetjes financiare dhe sociale për fëmijët dhe familjet kujdestare, si dhe harmonizimit të praktikave me standardet ndërkombëtare dhe procesin e integritimit në BE.

5) Zhvillimi dhe funksionalizimi i një sistemi të integruar të monitorimit dhe vlerësimit të kujdesit alternativ brenda vitit 2026;

6) Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të stafit përgjegjës për kujdesin alternativ brenda vitit 2027;

7) Standardizimi i praktikave dhe protokolleve për kujdesin alternativ brenda vitit 2026;

8) Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit dhe familjeve biologjike në procesin e kujdesit alternativ brenda vitit 2026.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Për të përcaktuar opsionin më të mirë për zgjidhjen e problematikave të mësipërme janë marrë në shqyrtim opsionet e mëposhtme:

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së

Ky opsion konsiston në mosmarrjen e ndonjë mase të re ligjore ose nënligjore, duke u fokusuar vetëm në përmirësimin e praktikave ekzistuese përmes udhëzimeve jo-detyrues, programeve të trajnimit, mbështetjes teknike për bashkitë, rekomandimeve profesionale dhe forcimit të koordinimit ndër-institucional. Aktualisht, kujdestaria familjare në Shqipëri nuk është e rregulluar nga një ligj i posaçëm, por nga një akt nënligjor - VKM nr. 149/2018, e miratuar në zbatim të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH” dhe VKM nr. 578, datë 03.10.2018, e miratuar në zbatim të Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Kjo formë kujdesi ka filluar tashmë të zbatohet në vend duke shënuar një hap të parë drejt zhvillimit të këtij mekanizmi si alternativë ndaj kujdesit rezidencial. Megjithatë, mungesa e një kuadri ligjor të plotë dhe të qëndrueshëm e bën këtë opsion të brishtë nga pikëpamja institucionale dhe rregullatore. Vijimi i zbatimit të kujdestarisë familjare vetëm mbi bazën e akteve nënligjore do të sillte pasiguri në praktikë, si në aspektin e garantimit të të drejtave të fëmijës ashtu edhe në mbështetjen e kujdestarëve. Si rrjedhojë, kjo situatë pengon ndërtimin e një sistemi mirëfunksionues për mbrojtjen e fëmijëve, në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe standardet ndërkombëtare të kujdesit alternativ. Shteti do të vijonte të aplikojë dispozitat aktuale me interpretim të zgjeruar, pa krijuar detyrime të reja të zbatueshme.

Avantazhet:

- Nuk kërkon ndryshime ligjore të menjëhershme, pasi kujdestaria familjare tashmë parashikohet në VKM nr. 149/2018 dhe VKM nr. 578/2018.
- Shmang kostot administrative të përgatitjes dhe zbatimit të një ligji të ri, nuk gjeneron kosto shtesë të konsiderueshme, pasi mbështetjet e infrastrukture aktuale ligjore dhe administrative.
- Zbatim i vazhdueshëm i procedurave ekzistuese, pa nevojën e riorganizimit institucional.

Disavantazhet:

- Mungesë e një kuadri të qëndrueshëm ligjor, duke e bërë sistemin të brishtë dhe të varur nga ndryshimet e politikave afatshkurtra, nuk krijon detyrime ligjore të qarta dhe të zbatueshme për institucionet.
- Nuk garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në mënyrë të barabartë në të gjithë vendin.
- Mungesë harmonizimi me standardet ndërkombëtare, sidomos me UN Guidelines on Alternative Care.
- Pengon transformimin e shërbimeve rezidenciale, pasi nuk adreson nevojën për një politikë kombëtare të konsoliduar.

Në këtë skenar, pothuajse të 207 fëmijët aktualisht në kujdes rezidencial do të vijonin të jetonin në institucione të kujdesit në vend të deinstitutionalizimit. Kosto mesatare për një fëmijë në kujdes rezidencial është 171.000 lekë në muaj, duke rezultuar në një kosto totale nominale prej të paktën 424.764.000 lekë në vit për të gjithë 207 fëmijët (kosto konservatore, duke marrë për bazë koston mesatare të kujdesit institucional për fëmijët me zhvillim tipik). Vlera prezante aktuale e koston për periduhën 2026 – 2035 do të ishte 3.279.915.015 ALL (diskontimi i kostove shtesë është kryer në fund të çdo viti, duke përdorur normën sociale të diskontimit prej 5%. Vlera aktuale neto është llogaritur si shuma e flukseve vjetore të diskontuara). Në këtë skenar, asnjë prej përfitimeve ekonomike e sociale për shkak të mirërritjes së fëmijëve nuk do të materializohej, pra përfitimet janë 0 ALL. Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) (Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total) do të ishte -3.3 miliardë lekë.

Opsioni 1 - Një nga opsionet e mundshme do të ishte kryerja e ndryshimeve në ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” si dhe në ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet dhe kujdesin shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Megjithatë, ky opsion nuk do të sillte ndryshimet thelbësore të nevojshme për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të kujdestarisë familjare.

Ndryshimet e tilla do të rrezikonin të deformonin qëllimet dhe strukturën konceptuale të të dy ligjeve, të cilat trajtojnë institute të ndryshme të përkuajdesit dhe mbrojtjes sociale. Përfshirja e dispozitave të detajuara mbi kujdestarinë familjare në këto ligje do të kërkonte një qasje të ngjashme edhe për format e tjera të kujdesit social ndaj fëmijëve, duke e bërë kështu legjislacionin të ngarkuar, të fragmentuar dhe më pak funksional. Prandaj, ndryshimet brenda këtyre ligjeve nuk përbëjnë qasjen më të përshtatshme për krijimin e një kuadri të plotë dhe koherent ligjor për kujdestarinë familjare. Zgjidhja më efektive do të ishte hartimi i një ligji të veçantë, që adreson në mënyrë tërësore parimet, procedurat, standardet dhe përgjegjësitë institucionale për këtë formë kujdesi alternativ.

Avantazhet

- Përdor kuadrin ligjor ekzistues, duke shmangur hartimin e një ligji krejtësisht të ri.
- Mund të adresojë disa boshllëqe urgjente, lidhur me definicionet, rolet institucionale ose mbështetjen për kujdestarët.
- Kosto të moderuara, pasi ndryshimet do të integroheshin në ligjet aktuale.

Disavantazhet

- Rrezikon të krijojë mbivendosje dhe fragmentim ligjor, duke bërë më të vështirë zbatimin në praktikë.
- Nuk krijon një sistem të qëndrueshëm, pasi kujdestaria mbetet vetëm një ndër komponentët e ligjeve, jo një mekanizëm i zhvilluar më vete.
- Vështirëson integrimin e plotë të standardeve ndërkombëtare, të cilat kërkojnë trajtim të gjerë dhe specifik.

- Nuk nxit ndryshimin e nevojshëm sistematik, sidomos për transformimin nga institucionet drejt kujdesit familjar.

Duke marrë në konsideratë numrin aktual prej 201 fëmijësh në institucione rezidenciale, nga të cilët 43 me aftësi të kufizuara (me kosto edhe më të lartë të kujdesit), pritet që miratimi i vetëm i amendimeve në kuadrin ekzistues ligjor (Opsioni 1) të rezultojë nga njëra anë **në një normë më të ulët mbulimi me kujdestari familjare** dhe nga ana tjetër në një **periudhë më të gjatë qëndrimi në institucion për fëmijët** që kalojnë në kujdes alternativ familjar. Në një skenar konservator, ku supozohet se nën ligjin e ri të posaçëm (Opsioni 2) 100% e fëmijëve kalojnë në kujdestari familjare nga viti i dytë, ndërsa nën skenarin e amendimeve vetëm 60%; dhe se fëmijët që kalojnë në kujdestari nën Opsionin 1 qëndrojnë mesatarisht 3 muaj më shumë në institucion, kostoja shtesë vjetore e Opsionit 1 vlerësohet rreth 163 milionë ALL për vitin e parë, 192 milionë lekë në vitin e dytë dhe 170 milionë ALL në vit nga viti i tretë. E diskontuar në një horizont dhjetëvjeçar me normë 5%, kjo përkethehet në rreth **1.3 miliardë ALL kosto shtesë** për buxhetin publik, pa përfshirë faktin që kostoja reale për fëmijët me aftësi të kufizuara është edhe më e lartë se supozimi konservator i përdorur në llogaritje (*diskontimi i kostove shtesë është kryer në fund të çdo viti, duke përdorur normën sociale të diskontimit prej 5%. Vlera aktuale neto është llogaritur si shuma e flukseve vjetore të diskontuara*). Kjo tregon se ligji i ri i posaçëm jo vetëm që është më i qartë dhe i parashikueshëm në plan ligjor, por gjithashtu paraqet një zgjidhje dukshëm më kosto-efektive në afatmesëm dhe afatgjatë.

	Nr. I fëmijeve ne kujdes rezidencial*muajt	Nr. I fëmijeve ne kujdestari alternative*muajt	Kosto e kujdesit (nominale)	Kosto e kujdesit (e diskontuar)
Viti 1	145 fëmije*12 muaj, 62 fëmijë*9 muaj	62 fëmijë*3 muaj	408 582 000	389 125 714
Viti 2	83 fëmijë*12 muaj, 21 fëmijë*6 muaj	103 fëmijë*12 muaj, 21 fëmijë*6 muaj	306 270 000	277 795 918
Viti 3	83 fëmijë*12 muaj	124 fëmijë*12 muaj	295 308 000	255 098 154
...				
Viti 10	83 fëmijë*12 muaj	124 fëmijë*12 muaj	295 308 000	181 293 495
Gjithsej			3 077 316 000	2 398 112 956

Opsioni 2 - Hartimi i një ligji të ri

Ky opsion parashikon krijimin e një kuadri të ri ligjor dhe rregullator të veçantë për kujdestarinë familjare, si një nga format e përkujdesit social që garanton mbrojtjen e fëmijëve në një mjedis familjar. Ky është opsioni më i përshtatshëm dhe më i qëndrueshëm, pasi do të mundësonte ndërtimin e një baze të qartë, gjithëpërfshirëse dhe të harmonizuar për organizimin, standardet dhe mbikëqyrjen e kujdestarisë familjare në nivel kombëtar dhe vendor.

Duke qenë se kujdestaria familjare tashmë në një formë të kufizuar njihet dhe zbatohet në vend si dhe do të ketë një transferim të burimeve financiare nga kujdesi rezidencial në familje, kostot e zbatimit të sistemit të ri ligjor nuk do të jenë ndjeshëm më të larta sesa ato që shoqërojnë zbatimin e kuadrit aktual. Megjithatë, një ligj i posaçëm është i domosdoshëm për të garantuar zhvillimin e një sistemi funksional dhe afatgjatë të kujdesit alternativ familjar, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me objektivat kombëtare për forcimin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

Avantazhet

1. Krijimi i një kuadri ligjor të qartë dhe gjithëpërfshirës

Një ligj i ri mund të harmonizojë të gjitha dispozitat përkujdesëse për fëmijët në një dokument të vetëm, duke shmangur shpërndarjen e rregulloreve dhe aktet nënligjore të fragmentuara.

2. Garanton një strukturë të qartë për organizimin, standardet e kujdestarisë dhe mbikëqyrjen në nivel kombëtar dhe vendor.
3. Siguron qëndrueshmëri dhe funksionalitet afatgjatë. Një ligj i veçantë do të lehtësojë zhvillimin e sistemit të kujdesit alternativ familjar për një periudhë të gjatë, duke u bazuar në standarde ndërkombëtare.
4. Redukton rreziqet e keqinterpretimit të normave ligjore që ekzistojnë në kuadrin aktual të fragmentuar.
5. Preferenca për shkak të teknikes legislative. Analiza tekniko-ligjore tregon se ndryshimi i ligjit aktual për të përfshirë këtë sistem do të prekte më shumë se 50% të dispozitave aktuale, duke krijuar rrezikun e pakuptueshmërisë juridike dhe ngatërimeve në praktikën gjyqësore. Hartimi i një ligji të ri shmang këtë problem, duke siguruar qartësi dhe stabilitet juridik.
6. Rrit mbështetjen institucionale dhe koordinimin. Një ligj i ri lehtëson krijimin e mekanizmave koordinues ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore, duke përmirësuar mbikëqyrjen dhe raportimin mbi kujdestarinë alternative.
7. Harmonizimi me standardet ndërkombëtare. Ligji i ri mund të integrojë në mënyrë të drejtëpërdrejtë dispozitat e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe udhëzimet për kujdesin alternativ, pa u varur nga ndryshimet e shpërndara në ligjet ekzistuese.

Disavantazhet

- Kërkon kohë më të gjatë për hartim dhe miratim, përfshirë konsultime të gjera ndërsektoriale.
- Fillimisht kërkon investime për ngritjen e kapaciteteve, si trajnime, standarde të reja dhe sisteme monitorimi.

Opsioni 3 jorregullator – Nxitja e kujdestarisë familjare

Ky opsion parashikon **mbajtjen e kuadrit ligjor ekzistues** dhe përmirësimin e kujdestarisë familjare përmes **masave jorregullatore**, si:

- Programet pilot dhe projekteve financuese të mbështetjes së familjeve kujdestare;
- Trajnime dhe kapacitete për strukturat vendore dhe punonjësit socialë;
- Promovim dhe fushata ndërgjegjësimi për përfitimet e kujdestarisë familjare;
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe koordinimi mes shërbimeve sociale dhe organizatave jofitimprurëse;
- Përmirësimi i protokolleve dhe praktikave të punës brenda kuadrit ekzistues ligjor.

Ky opsion nuk ndryshon legjislacionin aktual dhe nuk krijon një kuadër ligjor të ri për kujdestarinë alternative. Ai fokusohet te instrumentet jorregullatore dhe masat mbështetëse për të promovuar kujdestarinë familjare.

Avantazhet:

1. Shpenzime të ulëta dhe fleksibilitet i lartë

- Nuk kërkon hartimin e një ligji të ri dhe ndryshime të mëdha ligjore, prandaj shpenzimet administrative dhe ligjore janë minimale.
- Mund të adaptohet shpejt dhe të implementohet gradualisht.

2. Promovim i menjëhershëm i kujdestarisë familjare

- Mund të nxitet përdorimi i formave familjare të kujdesit përmes projekteve pilot, trajnimeve dhe fushatave ndërgjegjëse.
- Ofron mbështetje financiare dhe trajnuese për familjet kujdestare pa pritshmëri ligjore.
- 3. **Rritja e kapaciteteve dhe bashkëpunimit institucional**
 - Lejon përf forcimin e njësive sociale, strukturave vendore dhe bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse.
- 4. **Më pak pengesa politike dhe ligjore**
 - Nuk kërkon miratimin e ligjit në parlament, prandaj shmang pengesa burokratike apo debatet politike mbi një kuadër të ri ligjor.

Disavantazhet:

1. **Mungesa e qartësisë ligjore dhe qëndrueshmërisë**
 - Kuadri aktual ligjor nuk adreson plotësisht kujdestarinë familjare; pa një ligj të ri, rregullat mbeten të fragmentuara dhe shpesh të paqarta.
 - Masat jorregullatore nuk janë detyruese, prandaj ndikimi i tyre mund të jetë i kufizuar dhe jo uniform në të gjithë vendin.
2. **Rreziku i fragmentimit dhe zbatimit jo të njëtrajtshëm**
 - Strukturat vendore mund të interpretojnë ose zbatojnë praktikën e rekomanduar në mënyra të ndryshme, duke krijuar pabarazi mes komuniteteve.
3. **Ndikim i kufizuar mbi sistemin rezidencial**
 - Ky opsion nuk siguron transferimin sistematik të fëmijëve nga kujdesi rezidencial në kujdestari familjare.
 - Nuk garanton monitorimin ligjor dhe mbikëqyrjen institucionale të procesit të kujdesit alternativ.
4. **Mungesa e harmonizimit me standardet ndërkombëtare**
 - Pa një ligj të ri, është e vështirë të integrohen plotësisht dispozitat e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe Udhëzuesi për Kujdesin Alternativ.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

1. *Identifikoni grupet e prekura.*
2. *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
3. *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - a. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - b. *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - c. *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 - d. *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
4. *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - a. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - b. *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
5. *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - a. *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - b. *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
6. *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - a. *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*

- b. Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
- c. Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).

Grupet që prek zbatimi i kësaj politike janë:

- **Qytetarët / fëmijët:** Preken drejtpërdrejt, pasi politika synon mbrojtjen dhe përkujdesjen për fëmijët pa kujdes prindëror ose në rrezik për ta humbur atë. Përfituesit kryesorë janë fëmijët që vendosen në kujdes alternativ, të cilët përfitojnë nga një sistem i qartë ligjor, mjedis familjar i sigurt dhe mbështetje psiko-sociale.
- **Familjet kujdestare:** Përfitojnë mbështetje financiare, shërbime trajnuese dhe monitorim për të ofruar kujdes cilësor për fëmijët.
- **Biznesi / subjektet:** Preken në mënyrë të tërthortë, përmes certifikimit dhe bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale, duke rritur angazhimin dhe përgjegjësinë për standardet e kujdesit alternativ.
- **Buxheti i Shtetit:** Përfiton nga përdorimi më efektiv i burimeve publike, përmes reduktimit të shpenzimeve të kujdesit institucional dhe përmirësimit të menaxhimit financiar të shërbimeve sociale.

1. Qytetarët / Fëmijët

Ndikimet sociale:

- Fëmijët përfitojnë mbrojtje të drejtpërdrejtë nga rreziqet sociale, përfshirë braktisjen, dhunën ose neglizhencën.
- Vendosja në kujdes alternativ familjar ose komunitar rrit stabilitetin emocional dhe sigurinë psikologjike.
- Promovohet integrimi shoqëror dhe barazia, pasi fëmijët përfitojnë nga standarde të unifikuara të kujdesit, të ngjashme me ato të fëmijëve që jetojnë në familje biologjike.
- Përmirësohet besimi i publikut tek shteti dhe institucionet sociale, pasi masat e qarta dhe të standardizuara tregojnë vëmendje ndaj interesit më të mirë të fëmijës.

Ndikimet ekonomike:

- Fëmijët që përfitojnë kujdes familjar kanë mundësi më të mirë për arsim dhe zhvillim aftësish, që në të ardhmen rrit potencialin e tyre ekonomik.
- Zvogëlohet rreziku i varfërisë dhe i nevojës për mbështetje sociale afatgjatë.

Ndikimet financiare:

- Reduktimi i numrit të fëmijëve në institucionet rezidenciale ul shpenzimet e drejtpërdrejta të shtetit për kujdesin institucional.
- Përfitimet indirekte përfshijnë ulje të shpenzimeve të emergjencës sociale dhe shërbimeve shëndetësore dhe psikologjike, për shkak të kujdesit më cilësor në familje.

Ndikimet monetare të drejtpërdrejta:

- Shpenzimet e lidhura me vendosjen e fëmijëve në kujdes alternativ familjar:
 - Për periudhën 2026–2035, për 207 fëmijë, kostoja totale e kujdesit është 2.3 miliardë lekë (vlerë nominale).
 - Vlëra prezente aktuale e kësaj kostoje me një faktor zbritjeje 5% është 1.765 miliardë lekë.
- Përfitimet monetare të drejtpërdrejta për fëmijët dhe familjet përfshijnë:

- Transferimet financiare për familjet kujdestare dhe mbështetje për shërbime sociale: vlera prezente aktuale 392 milionë lekë për periudhën 10-vjeçare.

Ndikimet monetare të tërthorta / afatgjata:

- Përfshirja e fëmijëve në kujdes familjar dhe edukim cilësor rrit potencialin e tyre ekonomik të ardhshëm. Duke supozuar një periudhë pune 40-vjeçare dhe shpërndarje normale të fitimeve sipas kategorive të të ardhurave:
 - Vlera prezente e përfitimeve totale në 40 vjet për 207 fëmijë është rreth 2.4 miliardë lekë.
 - Efekti multiplikator ekonomik për shkak të rritjes së konsumit dhe taksave të paguara nga fëmijët që rriten në kushte më të mira është përfshirë në këtë vlerë.

Arsyet pse nuk mund të përcaktohen disa ndikime monetare:

- Disa përfitime sociale dhe psikologjike (p.sh., stabiliteti emocional, ulja e stresit dhe dhunës) nuk mund të kvantifikohen lehtësisht në terma monetarë, pasi nuk ka një treg të drejtpërdrejtë për këto vlera.

2. Familjet kujdestare

Ndikimet sociale:

- Rritet përfshirja e familjeve në procesin e kujdesit dhe riintegritit të fëmijëve, duke ndihmuar zhvillimin e aftësive prindërore dhe rritjen e përkushtimit ndaj fëmijëve në kujdes.
- Familjet përfitojnë mbështetje psikologjike dhe trajnim për menaxhimin e nevojave të veçanta të fëmijëve.
- Ndërveprimi me institucionet dhe shërbimet sociale forcon rrjetin mbështetës të familjes, duke ulur ndarjet ose krizat familjare.

Ndikimet ekonomike:

- Mundësia për të punuar dhe për të kontribuar ekonomikisht rritet, pasi mbështetja financiare dhe shërbimet e asistencës ulin barrën e kujdesit të përditshëm.
- Familjet që marrin mbështetje financiare dhe sociale kanë stabilitet ekonomik më të madh, duke reduktuar varësinë nga ndihma të tjera sociale.

Ndikimet financiare:

- Familjet marrin pagesa direkte dhe transfertat financiare që u mundësojnë të përmbushin shpenzimet për ushqim, edukim dhe kujdes shëndetësor për fëmijët.
- Përfitimet financiare shoqërohen me standardizim të monitorimit, duke siguruar përdorim efektiv të mjeteve dhe reduktim të keqpërdorimeve.

Ndikimet monetare të drejtpërdrejta:

- Mbështetje financiare për familjet kujdestare: për periudhën 2026–2035, pjesë e kostos totale prej 2.3 miliardë lekë shkon në transfertat direkte për familjet.
- Mbështetje sociale dhe shërbime trajnuese: pjesë e kostos totale e përfshirë në buxhetin e shërbimeve sociale (vlera saktësisht e ndarë nuk është përcaktuar, por përfshihet brenda 1.765 miliardë lekëve vlerë prezente).

Ndikimet monetare të tërthorta:

- Reduktimi i barrës financiare të familjeve që marrin fëmijë në kujdes alternativ, duke ulur shpenzimet për edukim, shëndetësi dhe ushqim që do të duheshin në rast të mbajtjes së fëmijëve jashtë familjes.
- Përfitimet e mundshme afatgjata nga aftësimi i familjeve kujdestare për të ofruar kujdes profesional, që mund të krijojë mundësi për angazhime ekonomike të mëtejshme.

Arsyet pse nuk mund të përcaktohen disa ndikime monetare:

- Vlerësimi i përfitimeve që lidhen me zhvillimin emocional dhe social të fëmijëve në familje është i vështirë për t'u monetarizuar.
- Përfitimet nga stabiliteti social i familjes, ulja e stresit dhe rritja e cilësisë së jetës nuk mund të matet saktësisht në lekë.

3. Biznesi / Ofruesit e shërbimeve sociale

Ndikimet sociale:

- Ofruesit certifikohen dhe monitorohen për të ofruar shërbime cilësore, duke rritur besueshmërinë dhe cilësinë e kujdesit alternativ në komunitet.
- Përmirësohet bashkëpunimi me institucionet publike dhe organizatat jofitimprurëse, duke krijuar standarde të njëjta për gjithë vendin.

Ndikimet ekonomike:

- Licencimi dhe standardizimi i shërbimeve kërkojnë investime në kapacitete, trajnime dhe infrastrukturë.
- Përfiton reputacioni dhe mundësitë për projekte të financuara nga shteti ose donatorë, duke krijuar mundësi për zhvillim ekonomik të sektorit jofitimprurës.

Ndikimet financiare:

- Kosto fillestare për përmbushjen e standardeve mund të jetë e konsiderueshme, por mbi të gjitha sigurohet stabilitet financiar afatgjatë dhe akses në financime publike dhe fonde donorësh.

Ndikimet monetare të drejtpërdrejta:

- Kosto e licencimit, trajnimeve dhe përshtatjes me standardet e projektligjit. Kjo përfshihet në pjesën e buxhetit të shërbimeve sociale, por nuk ka një ndarje të detajuar monetare për secilin operator.
- Mundësia për të marrë financim shtetëror ose donator për zhvillimin e shërbimeve: ndikim pozitiv në të ardhurat e bizneseve.

Ndikimet monetare të tërthorta:

- Rritja e reputacionit dhe cilësisë së shërbimeve mund të sjellë më shumë kontrata dhe bashkëpunime në të ardhmen.
- Efekt multiplikator për ekonominë e sektorit social, përmes zgjerimit të shërbimeve dhe rritjes së punësimit të stafit.

Arsyet pse nuk mund të përcaktohen disa ndikime monetare:

- Vlerësimi i të ardhurave të ardhshme nga reputacioni dhe rritja e cilësisë së shërbimeve është subjektiv dhe varet nga shumë faktorë të jashtëm (e.g., politika financiare e shtetit, bashkëpunimet me donatorë).

4. Buxheti i Shtetit

Ndikimet sociale:

- Përmirësimi i sistemit të kujdesit alternativ dhe zvogëlimi i institucionalizimit sjell ulje të pasojave sociale negative, si dhuna, marginalizimi ose braktisja e fëmijëve.
- Rrit besimin e qytetarëve tek institucionet sociale dhe shteti, duke ndikuar pozitivisht në stabilitetin social.

Ndikimet ekonomike:

- Zvogëlohen kostot afatgjata të institucionit rezidencial, duke kursyer burime që mund të përdoren për shërbime të tjera sociale ose investime në komunitet.
- Efekt multiplikator në ekonomi: rritja e konsumit nga familjet e mbështetura, përmirësimi i kapaciteteve të fëmijëve që do të kontribuojnë në ekonominë e ardhshme.

Ndikimet financiare:

1. Kostoja e kujdesit alternativ dhe rezidencial

Buxheti i shtetit për implementimin e kujdesit alternativ për periudhën 2026–2035 është përcaktuar duke marrë parasysh:

- **Numrin e fëmijëve në kujdes rezidencial dhe alternative:**
 - Viti 1: 207 fëmijë në institucione për 6 muaj dhe 104 fëmijë në kujdestari alternative për 6 muaj; numri i fëmijëve të vendosur në kujdestari alternative është 103 për 6 muaj.
 - Vitin pasues (Viti 2–10), të gjithë 207 fëmijë përfshihen në kujdestari alternative për 12 muaj në vit.
- **Kostoja nominale e kujdesit:**
 - Viti 1: 370,998,000 lekë
 - Viti 2: 208,656,000 lekë
 - Viti 3: 208,656,000 lekë
 - ... deri në Viti 10: 208,656,000 lekë

	Nr. i fëmijëve në kujdes rezidencial*muajt	Nr. i fëmijëve në kujdestari alternative*muajt	Kosto e kujdesit (nominale)	Kosto e kujdesit (e diskontuar)
Viti 1	207 fëmijë*6 muaj, 104 fëmijë*6 muaj	103 fëmijë*6 muaj	370 998 000	353 331 429
Viti 2		207 fëmijë*12 muaj	208 656 000	189 257 143
Viti 3		207 fëmijë*12 muaj	208 656 000	180 244 898
...				
Viti 10		207 fëmijë*12 muaj	208 656 000	128 096 684
Gjithsej			2 248 902 000	1 765 797 752

2. Përfitimet monetare dhe efektet multiplikatore

Përfitimet monetare të politikës janë llogaritur duke kombinuar tre elemente:

1. Transferimet financiare dhe mbështetja për familjet kujdestare:
 - Për periudhën 10-vjeçare, vlera prezente aktuale e këtyre përfitimëve është 392 milionë lekë.
2. Taksa indirekte dhe efekti multiplikator nga konsumimi i rritur:
 - Kur familjet kujdestare marrin mbështetje financiare, ato rrisin konsumimin në komunitet, gjë që gjeneron të ardhura shtesë për buxhetin e shtetit përmes taksave indirekte.
3. Përfitimet afatgjata nga edukimi dhe zhvillimi ekonomik i fëmijëve:
 - Duke supozuar një periudhë pune 40-vjeçare dhe shpërndarje normale të fitimeve sipas kategorive të të ardhurave, vlera prezente aktuale e përfitimëve nga ky program për 207 fëmijë është 2.4 miliardë lekë.
 - Këto përfshijnë uljen e shpenzimeve sociale në të ardhmen (p.sh., asistencë sociale, shërbime shëndetësore dhe psikologjike), rritjen e konsumit dhe taksat e ardhshme që do të paguheshin nga këta individë.

Vlera aktuale neto dhe raporti kosto-përfitim

- **Vlera aktuale neto (NPV)** = Përfitimet aktuale – Kosto aktuale
 - 2.4 miliardë lekë (përfitim në 40 vite) – 1.765 miliardë lekë (kosto e diskontuar) $\approx$ **1.4 miliardë lekë**
- **Raporti kosto-përfitim** = 1:1.9

- Për çdo 100 lekë të shpenzuara nga buxheti i shtetit, shoqëria përfiton 190 lekë në formë përfitimesh monetare dhe indirekte.

Shpenzimet për periudhën PBA 2026–2028

- Kosto nominale për tre vitet e para të periudhës së planit analitik të buxhetit (PBA): 412 milionë lekë
- Ky shpenzim përfshin vendosjen e fëmijëve në kujdes alternativ dhe fillimin e mbështetjes financiare dhe sociale për familjet kujdestare.
- Efekti i diskontuar nuk është llogaritur për këtë periudhë specifike në detaje, por është pjesë e kostos totale të diskontuar 1.765 miliardë lekë për 10 vitet.

Konkluzion sasiore

Analiza tregon se investimi në kujdesin alternativ nuk është vetëm socialisht i rëndësishëm, por edhe **ekonomikisht efikas**.

- Politika e propozuar ka një **efekt neto pozitiv mbi buxhetin dhe shoqërinë**, me një raport kosto-përfitim 1:1,9.
- Efektet monetare përfshijnë koston e drejtpërdrejtë të kujdesit, përfitimet nga transfertat financiare, taksat indirekte, efektin multiplikator dhe përfitimet afatgjata nga zhvillimi ekonomik i fëmijëve.
- Përfitimet jo monetare (psikologjike, sociale dhe integrimi i fëmijëve) nuk janë llogaritur monetarisht, por ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në shëndetin social dhe mirëqenien e shoqërisë.

Kufizimet e analizës:

Supozimet për përfitimet afatgjata:

1. **Përfitimet monetare afatgjata bazohen në supozime për punësimin dhe të ardhurat e fëmijëve në të ardhmen. Këto janë vlerësime standarde në analizat socio-ekonomike, por nuk mund të konsiderohen të sakta për secilin individ.**
2. **Efektin multiplikator dhe taksat indirekte:**
Përfitimet janë vlerësime bazuar në konsum dhe rritjen ekonomike të komunitetit, jo në të dhëna konkrete të tregut.
3. **Efektet sociale dhe psikologjike:**
Nuk janë monetarizuar, por ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në mirëqenien e fëmijëve dhe shoqërisë.
4. **Kosto për ofruesit e shërbimeve:**
5. **Analiza nuk përfshin kostot e mundshme të licencimit, trajnimeve dhe burimeve njerëzore për organizatat jofitimprurëse ose private.**

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (Jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i preferuar, është opsioni nr. 2, i cili mundëson hartimin e një kuadri rregullator të ri.

Ky është opsioni më i përshtatshëm, sepse do të krijonte një kuadër të qëndrueshëm, të qartë dhe të plotë për kujdesin në familje ndaj fëmijëve në nevojë për këtë kujdes. Ndërkohë që kujdestaria familjare njihet dhe zbatohet në vend, edhe kostoja e hartimit dhe miratimit të një ligji të ri do të ishte jo shumë më e lartë se ajo për opsionin 1, por e nevojshme për qëllimin të cilin adreson miratimi i një sistemi të qëndrueshëm të kujdesit alternativ në familje në vendin tonë.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar, është opsioni nr. 2, i cili mundëson hartimin e një kuadri rregullator të ri.

Qëllimi i projekt ligjit është të garantojë ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje një mjedis të përshtatshëm familjar për fëmijët në nevojë për përkujdes dhe mbrojtje. Ky projektligj synon të ruajë dhe garantojë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në një mjedis të sigurt, mbështetës dhe përfshirës familjar, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, duke marrë parasysh nevojat individuale dhe promovuar zhvillimin e shëndetshëm të tij/saj.

Risitë që sjell ky Projektligj janë të shumëfishta, me ndikim të drejtpërdrejtë në praktikë dhe përfshijnë:

- Informimi dhe konsiderimi i mendimit dhe vendimi të fëmijës, i cili përfshihet në çdo vendim që prek jetën e tij;
- Kujdestaria profesionale kthehet në një profesion të njohur dhe të mbrojtur ligjërisht, duke garantuar cilësi, stabilitet dhe mbështetje institucionale për kujdestarët;
- Kujdesi emergjent për fëmijët e sapoidentifikuar në situata rreziku (p.sh. dhunë, trafikim, mungesë të kujdesit prindëror);
- Financimi bëhet më i drejtë dhe i strukturuar, me mbështetje ekonomike si për fëmijët, ashtu edhe për familjet kujdestare;
- Sistemi i monitorimit elektronik mundëson gjurmueshmëri të plotë dhe shmang vendosjet e pasigurta apo të paarsyetuara;
- Standardet e shërbimit unifikohen për të gjithë territorin ku tanimë çdo fëmijë, kudo që ndodhet, do të marrë të njëjtin nivel kujdesi dhe mbrojtjeje.

Ky Projektligj do të zhvendosë fokusin nga institucioni te familja, do të forcojë rolin e bashkive si ofrues të shërbimeve të kujdesit alternativ në komunitet, do të profesionalizojë kujdesin alternativ duke ngritur një rrjet familjesh kujdestare të trajnuara e të mbështetura financiarisht, do të konsolidojë partneritetin me shoqërinë civile si partnerë të rëndësishëm dhe mbi të gjitha do të përmirësojë jetën e fëmijëve, duke u garantuar rritje në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe sa më afër modelit të familjes biologjike.

Analiza të ndryshme kanë vënë në pah se ka një mospërputhje të rasteve të vendosjes së fëmijës në përkujdesje alternative me aktet ligjore në fuqi si dhe mbivendosje të rregullimeve. Disa lloje të kujdesit alternativ të cilat njihen në praktikë nuk janë në ligj ose ka kuptime të ndryshme për to. Mungojnë parashikimet në lidhje me monitorimin e fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ për çdo rast. Miratimi i një ligji për kujdesin alternativ do të saktësojë dhe plotësojë kuadrin ligjor, sikurse do mënjanojë

mbivendosjet. Për të arsyetuar më shumë përzgjedhjen e kësaj opsioni është kryer analiza me shumë kriteret.

Për kryerjen e kësaj analize janë marrë në konsideratë 4 opsione:

Opsioni 0 – Ruajtja e Status-quo-s;

Opsioni 1- Kryerja e ndryshimeve në ligjin ;

Opsioni 2- Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri;

Opsioni 3- Jorregullator

Janë përcaktuar kriteret dhe është vendosur pesha për secilin kriter, si më poshtë vijon:

1. Efektiviteti i rregullave të qarta për kujdesin alternativ në familje, duke aplikuar kriteret në përputhje me Udhërrëfyesin e OKB-së, dhe aktet politike të BE-së, konsideruar që nuk ka një acis të BE-së për këtë çështje- 4;
2. Efektiviteti në forcimi i kapaciteteve të strukturave të dedikuara për çështjet sociale pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale- 3;
3. Forcimi i rolit dhe përgjegjësi të bashkive për kujdesin alternativ në familje - 2;
4. Harmonizim me legjislacionin në fuqi për shërbimet sociale ndaj fëmijëve në nevojë - 3;
5. Qartësia dhe kuptueshmëria juridike - 4;
6. Kosto-efektiviteti - 5.

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	O
Efektiviteti i rregullave të qarta për kujdesin alternativ në familje, duke aplikuar kriteret në përputhje me Udhërrëfyesin e OKB-së, dhe aktet politike të BE-së, konsideruar që nuk ka një acis të BE-së për këtë çështje.	4	0 (0)	3 (12)	4 (16)	
Efektiviteti në forcimi i kapaciteteve të strukturave të dedikuara për çështjet sociale pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.	3	0 (0)	3 (9)	3 (9)	
Forcimi i rolit dhe përgjegjësi të bashkive për kujdesin alternativ në familje	2	0 (0)	2 (4)	2 (4)	
Harmonizim me legjislacionin në fuqi për shërbimet sociale ndaj fëmijëve në nevojë	3	0 (0)	3 (9)	3 (9)	
Qartësia dhe kuptueshmëria juridike.	4	1 (4)	1 (4)	4 (16)	
Kosto-efektiviteti	5	1 (5))	3 (15)	5 (25)	
Pikët		9	53	79	

Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësohet se opsioni i preferuar është Opsioni 2 (hartimi i një ligji të ri). Arsyeja pse propozohet të procedohet me Opsionin 2 është sepse ndryshimet e propozuara në këtë politikë janë rrënjësore: riorganizim i shërbimit të kujdesit alternativ në familje, përcaktim i llojeve të kësaj shërbimi, përcaktim i rregullave procedurale, monitorimit dhe inspektimit.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Për zbatimin dhe monitorimin e këtij projektakti ngarkohen strukturat përgjegjëse për çështjet sociale në nivel qendror dhe vendor.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS)

- Institucioni drejtues për hartimin e politikave, legjislacionit dhe akteve nënligjore.
- Koordinon të gjitha hallkat institucionale
- Mbikëqyr dhe monitoron zbatimin e sistemit të ri.

b) Drejtoria e Politikave të Përkujdesjes Sociale dhe Shërbimeve Sociale

- Harton aktet nënligjore, protokollet, udhëzimet dhe standardet e shërbimit.
- Monitoron zbatimin e politikave

c) Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH)

- Autoritet përgjegjës për monitorimin e shërbimeve të kujdestarisë.
- Siguron trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm për punonjësit socialë dhe kujdestarët.

d) Bashkitë

- Zbatojnë në praktikë shërbimet e kujdestarisë familjare.
- Realizojnë vlerësimin e fëmijës, përzgjedhjen e familjeve, mbështetjen financiare dhe monitorimin periodik.
- Bashkëpunojnë me gjykatat në procedurat e vendosjes.

e) Institucionet e Drejtësisë (Gjykatat)

- Vendosin juridikisht kujdestarinë familjare, brenda afateve të përcaktuara në ligj

Rol thelbësor për hartimin e akteve nënligjore kanë Këshilli i Ministrave dhe ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

Pengesat e mundshme të zbatimit

- Kapacitete të kufizuara njerëzore dhe teknike në nivel vendor dhe qendror.
- Mungesë e eksperiencës së konsoliduar në zbatimin e kujdestarisë familjare.
- Rezistencë institucionale për zhvendosjen e fokusit nga kujdesi rezidencial drejt atij familjar.
- Mungesë familjesh kujdestare të trajnuara në numër të mjaftueshëm.

Masat për arritjen e objektivave të politikës

- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për standardet, procedurat dhe monitorimin e procesit.
- Trajnimi sistematik i punonjësve të strukturave qendrore dhe vendore.
- Fushata informuese për mobilizimin e familjeve kujdestare.
- Krijimi i mekanizmave për mbikëqyrje, raportim dhe vlerësim periodik.
- Rishpërndarja graduale e fondeve nga kujdesi rezidencial drejt kujdesit familjar.

Në kuadër të zbatimit të kësaj politike të propozuar, parashikohet të nxirren akte nënligjore, VKM dhe udhëzues i ministrit përgjegjës për çështjet sociale që rregullojnë:

- a.
- b. certifikimin e familjeve që ofrojnë kujdes alternativ profesional në familje (miratimi me vendim të Këshillit të Ministrave);

- c. procedurat dhe instrumentet për vlerësimin periodik të situatës së fëmijës së vendosur në shërbimin e kujdesit alternativ në familje;
- d. procedurat e referimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për kujdes alternativ në familje;
- e. vlerësimin, procedurën dhe vendimin për vendosjen në kujdes alternativ në familje;
- f. përgatitjen e fëmijës për vendosje në kujdes alternativ në familje;
- g. organizimin, funksionimin dhe qasjen në regjistrin e kujdesit alternativ në familje;
- h. monitorimit të situatës së fëmijës të vendosur në kujdes alternativ në familje;
- i. masën e financimit për kujdesin alternativ në familje dhe rregullat e përfitimit të financimit;
- j. organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në bashki dhe për procedurën e shqyrtimit të ankesave;
- k. standardet e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje.

- Gjithashtu, miratimi i një ligji të ri do të diktojë nevojën e rishikimit të ndonjë ligji në vijim, si p.sh. të dispozitave të Kodit të Familjes, ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet dhe kujdesin shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; dhe do të nevojitet të plotësohet me VKM-të përkatëse në lidhje me përkujdesin alternativ në familje. Elemente që kanë të bëjnë me kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masën e financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare etj., duke u parashikuar në kuadrin ligjor, do të plotësojnë situatën dhe do krijojnë kuadrin e duhur për këtë shërbim në përputhje me interesin më të lartë të fëmijëve.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Për monitorimin e këtij projektakti ngarkohen strukturat përgjegjëse për çështjet sociale në nivel qendror dhe vendor.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Njësia/punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor;
- Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror dhe rajonal;
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- Inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale.

Kriteret për matjen e realizueshmërisë së objektivave:

1. Korniza ligjore dhe nënligjore
 - Miratimi brenda afateve të ligjit të posaçëm dhe akteve nënligjore përkatëse.
 - Përafrimi i plotë me Konventën e OKB-së dhe Udhëzuesin për Kujdesin Alternativ.
2. Infrastruktura institucionale
 - Funksionalizimi i strukturave përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor (drejtoritë sociale, njësitë e kujdestarisë).
 - Kapacitetet administrative dhe profesionale të ngritura (numri i punonjësve të trajnuar).
3. Zbatimi i shërbimeve të kujdesit familjar

- Rritja e numrit të familjeve kujdestare të certifikuara dhe të trajnuara brenda afateve.
 - Ulja e numrit të fëmijëve në institucione rezidenciale me përqindjet e synuara.
 - Rritja e numrit të fëmijëve të vendosur në forma familjare të kujdesit.
4. Cilësia e shërbimeve
- Zbatimi i standardeve minimale të shërbimit dhe protokolleve.
 - Funksionimi i mekanizmave të monitorimit, raportimit dhe inspektimit sipas afateve.
5. Mbështetja financiare dhe qëndrueshmëria
- Sigurimi i fondeve të dedikuara për kujdestarinë familjare në buxhetin vjetor të shtetit.
 - Transferimi gradual i burimeve nga kujdesi rezidencial drejt kujdesit me bazë familjare.
6. Rezultatet për fëmijët
- Përmirësimi i treguesve të sigurisë, zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijëve në kujdestari familjare.
 - Përdorimi i planeve individuale të kujdesit dhe rishikimi periodik i tyre.
7. Transparenca dhe llogaridhënia
- Funksionimi i regjistrit elektronik të shërbimeve të kujdesit alternativ.
 - Publikimi i të dhënave vjetore të agreguara dhe indikatorëve të rezultateve.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.7
Kosto për buxhetin - një herë	370.998						

Kosto për buxhetin - në vazhdimësi	-	208.656	208.656	208.656	208.656	208.656	208.65
Kosto për bizneset - një herë							
Kosto për bizneset - në vazhdimësi							
Kosto për grupet e tjera - një herë							
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi							
Kosto në total	370.998	370.998	370.998	370.998	370.998	370.998	370.99
Kosto e zbritur = Kosto në total x Faktori zbritës	353.331	353.331	353.331	353.331	353.331	353.331	353.33
Përfitimet për buxhetin – një herë							
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi	392						
Përfitimet për grupet e tjera – një herë							
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi							
Përfitimet për biznesin – një herë							
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi							
Përfitimet totale	392						
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës	392						
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	2,4 miliardë						
Vlera prezente aktuale e kostos në total	1,765 miliardë						
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	1,4 miliardë						

Shënim: Përfitimet për buxhetin, bizneset dhe grupet e tjera janë të integruara në vlerën totale prezente aktuale të përfitimeve dhe efektin multiplikator, sipas analizës së mëparshme. Vlerat e detajuara për vitet individuale nuk janë dhënë, ndaj tabela shërben si përmbledhje e diskontuar për 10 vitet.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsiioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	1.765	2.4	0.635

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

EVIS SALA

